

PLANI RAJONAL I TRASHËGIMISË JUG

2015 - 2018



Support to the Promotion of Cultural Diversity

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Plani Rajonal i Trashëgimisë Jug 2015 - 2018

MAJ 2015
Prishtinë

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët BE/KE - "Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë". Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

Parathënie

Komunitetet në mbarë botën gjithnjë e më shumë po kërkojnë mënyra për të qenë më aktive në qeverisjen lokale dhe për të marrë pjesë në menaxhimin e burimeve të tyre lokale. Pjesëmarrja demokratike me një qasje gjithëpërfshirëse, që ua siguron të gjithëve të drejtën për të praktikuar kulturën e tyre, është thelbësore për mirëqenien e komuniteteve ku identitetet e shumëfishta dhe diversiteti konsiderohen si asetë të rëndësishme.

Trashëgimia, si një prej themeleve të jetës bashkëkohore, luan një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik lokal duke qenë se kujdesi dhe menaxhimi i burimeve të trashëgimisë do të ofronin mundësi për komunitetet. Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë* (PDKK) ka qenë risiprurës në angazhimin e komuniteteve lokale me trashëgimin e tyre, teksa ka zhvilluar metodat dhe programet e përshtatshme lokale, duke u bazuar në standardet e miratuara.

Me qasjen e tij të integruar ndaj trashëgimisë dhe diversitetit, ky Plan i Trashëgimisë bashkon tiparet e veçanta të komuniteteve në një kornizë rajonale. Krahas asetëve të mirënjohura të trashëgimisë, ai tenton që të ndërlihd aspektet jo materiale të jetës bashkëkohore të komunitetit dhe e lidh atë me mënyrat e ndryshme në të cilat trashëgimia ka një rol. Natyra pjesëmarrëse e zhvillimit të Planit të Trashëgimisë nxit akterët lokal që të luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në një fazë të tij të hershme dhe në planifikimin e të ardhmes së tij. I tërë procesi i ka kushtuar vëmendje të veçantë qëndrueshmërisë dhe ka marrë masat e nevojshme duke siguruar shembuj dhe udhëzues konkret si dhe duke ndërtuar kapacitetet lokale për të vazhduar veprimet.

Plani i Trashëgimisë është një mjet i dobishëm i cili do të krijojë një platformë për palët e interesuara për të bashkuar forcat nën një strategji rajonale dhe për të shtruar rrugën për një marrëdhënie më të fuqishme në mes të veprimeve bazë dhe politikë bërjes në nivel qendror, duke ofruar një qasje dinamike dhe sistematike ndaj proceseve të zhvillimit lokal përmes shfrytëzimit të burimeve ekzistuese të trashëgimisë.

Në ndërkohë që nxit veprimet e bashkërenduara në mes të komunave të Kosovës Jugore, plani gjithashtu vendos një kornizë të përbashkët për të gjitha rajonet e Kosovës pasi që të gjitha ato e kanë vijuar procesin e njëjtë në zonat e tyre përkatëse. Në pajtim me parimet e pjesëmarrjes demokratike, diversitetin dhe veprimet risiprurëse, procesi synon që të udhëheq drejt zhvillimit të një Plani të Trashëgimisë të Kosovës i cili do t'i ndihmojë autoritetet e Kosovës në objektivin e tyre që të përafrohen me normat dhe standardet Evropiane.

Unë shpresoj se puna e Projektit të Përbashkët të PDKK-së në vendosjen e shembujve përmes ndihmës së tij teknike do të stimulojë autoritetet që të lehtësojnë punën e akterëve lokal dhe të krijojnë kushte për komunitetet në mënyrë që ata të vlerësojnë, mbrojnë dhe menaxhojnë më mirë trashëgiminë tonë të përbashkët.

Claudia Luciani

Drejtoreshë e Drejtorisë për Qeverisje Demokratike
Këshilli i Evropës
Strasburg

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opininionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Dritat, Kamera, Filmo!

Të gjithë ata që e kanë parë të paktën një film dokumentar në disa prej vendeve më atraktive në *Dokufestin* e Prizrenit, që nga brigjet e lumit e deri te muret e kështjellës, në fakt nuk kanë nevojë për ligjërata rreth fuqisë së kulturës dhe trashëgimisë kulturore - ata i kanë përjetuar ato në formën më të mirë të mundshme: jo vetëm audio-vizuale, por me plotë kuptimin e fjalës në "3D"!

Përmes dokumentarëve bashkëkohor qendra e vjetër e qytetit të Prizrenit, trashëgimia e së cilës është e mbrojtur me ligj të posaçëm, merr një jetë të re. Imazhet audio-vizuale jo vetëm që i sjellin dritë të re mureve dhe hapësirave, por është në koalicion të fuqishëm me publikun, qytetarët dhe shoqërinë civile, një tjetër lokacion si kinemaja e hapur e Lumbardhit mund të mbrohet si trashëgimi e ardhshme. Fakti se pasuritë e tilla gjenden gjithandej nëpër Kosovë nuk është vetëm çështje e traditës. Shumë prej zbulimeve të tilla ishin edhe rezultat konkret i programit të përbashkët shumë bashkëkohor të përkrahjes për *Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë* (PDKK-së), kryesisht të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës.

Kjo është pikërisht arsyeja pse planet e tilla ideohen, hartohen, diskutohen, miratohen dhe botohen: *në mënyrë që e kaluara të jetësohet sërish*. Apo për të qenë edhe më ambicioz: që njerëzit të krijojnë një ide për një *ndryshim* të mundshëm duke rigjetur disa vlera të vjetra pothuaj të harruara, si dialogu dhe mirëkuptimi i ndërsjellë. Kur flasim për Kosovën, me popullsinë më të re në Evropë, qasja e tillë përparimtare ndaj trashëgimisë është thelbësore. Mund ta quajmë diversitet, zhvillim i qëndrueshëm apo thjesht cilësi e jetës: çështja është se *qytetarët gjithmonë duhet të përfitojnë nga jetësimi i ideve të mira në praktikë*. Dokumentarët jo vetëm që dokumentojnë, ata krijojnë perspektiva të reja. Kreativiteti i festivalit bashkon vendimmarrësit e rajonit dhe zgjidhje të reja të përbashkëta politike mund të gjenden. Duke vepruar kështu, vetëdija për trashëgiminë e përbashkët bëhet shumë, shumë e prekshme: ajo fillon të krijoj njohuri të reja, vende të reja pune, mundësi të reja për biznes dhe - mbi të gjitha - ide të reja në mesin e gjeneratave të reja.

Unë shpresoj sinqerisht që ky Plan i Trashëgimisë do të nxisë të gjitha palët e interesuara që të dëshmojnë se ato mund të ankorohen me krenari në të kaluarën e trashëguar dhe të mirë orientuar në të ardhmen. Me mirëkuptim të tillë, ata të gjithë do të merrnin pjesë në një proces që nuk është vetëm një "pilot projekt" tjetër por, një proces që mund të shërbejë si frymëzim për projeksione më të përndritura – dhe veprime! - për të na nxjerrë të gjithë ne nga errësira e krizës bashkëkohore.

Samuel Žbogar,

Shef i Zyrës së Bashkimit Evropian

dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë.

Hyrje

Të gjithë ata që kanë qenë të angazhuar në projektin “Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK)” kanë punuar në drejtim të transformimit progresiv të shoqërive përmes demokracisë pjesëmarrëse, duke shfrytëzuar trashëgiminë si një vlerë të përbashkët. Në përqipimi që të sigurojmë mirëqenien e komuniteteve si një faktor kyç kontribues për të drejtat themelore të njeriut, përmes përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mjediseve jetësore. Duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe mjediset jetësore, ne duam të nxisim jetën e komunitetit duke u bazuar në individ aktiv, të përkushtuar përmes pjesëmarrjes së lirë dhe demokratike në procesin e zhvillimit. Ky proces i zhvillimit demokratik do të duhej të bazohet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve lokale të trashëgimisë, në krijimin e mundësive për qasje të barabartë në këto burime, dhe në shpërndarjen e drejtë të përfitimeve mes njerëzve në mënyrë të denjë.

Përfshirja e çiltër e komuniteteve në praktikën e jetës së tyre të përditshme, ku ato janë pjesëmarrës aktiv në proceset vendimmarrëse për zhvillim ekonomik dhe social, është jetike për të na ndihmuar neve që t'i qasemi ndërlikueshmërisë së të jetuarit së bashku. Përmes dialogut ndërkulturor ne kemi mundësinë që të krijojmë mirëkuptimin e ndërsjellë i cili është i domosdoshëm për t'u lidhur me njëri-tjetrin dhe të ripërkufizojmë marrëdhëniet tona. Ekzistenca jonë sot dhe perspektiva jonë e ardhme shpesh ndikohen nga e kaluara jonë dhe ajo që e kemi trashëguar nga e kaluara.

Trashëgimia duhet të përshkruhet thjesht si pasuritë dhe burimet kulturore dhe natyrore që civilizimet i trashëgojnë nga e kaluara; në nivel lokal, trashëgimia është një montazh i thurur i komuniteteve, vendeve, historive dhe peizazheve. Se si personalisht e perceptojmë trashëgiminë kryesisht varet nga moshja jonë - fëmijët kanë tendencën që të ndërlidhin trashëgiminë me çdo gjë të “vjetër” apo historike, të rriturit mund të ndërlidhin trashëgiminë me identitetin, ndërsa më të moshuarit mund ta ndërlidhin trashëgiminë me të “kaluarën e artë” dhe “humbjen” e vlerave. Mirëpo, të gjitha moshat e pranojnë rëndësinë e trashëgimisë në njëfarë niveli.

Njohja e rëndësisë së trashëgimisë nuk nënkupton gjithmonë vlerësimin dhe të kuptuarit e trashëgimisë. Trashëgimia po ashtu i është nënshtruar shkatërrimit; ndonjëherë me vetëdije, për arsye të ndërlikuara, ose pa vetëdije, duke e lënë të shkatërrohet, shpërbëhet dhe zhduket. Njohja e vlerës së trashëgimisë së shumëllojshme, nderimi dhe vendosja e saj në vendin e duhur në histori, është një proces sfidues por edhe ngazëllues, nëse menaxhohet si duhet.

Plani i Trashëgimisë për Kosovën Jugore është produkt i nismës rajonale të komunitetit i komponentit për Zhvillim Ekonomik Lokal të Projektit të Përbashkët të BE/KiE - Mbështetje të Promovimit të Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK) dhe pason nga një pilot projekt tashmë i kompletuar në Kosovën Perëndimore. Ai ofron një kornizë për identifikimin e strategjive më të përshtatshme për të çuar përpara objektivat, në kontekstin e zhvillimit të nismave dhe komponentëve turistik të qëndrueshëm, të bazuar në trashëgimi në kuadër të një strategjie të përgjithshme turistike për rajonin.

Komponenti i Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZhEL) të projektit të PDKK-së është frymëzuar nga dhe është i lidhur ngushtë me Pilot Projektin për Zhvillim Lokal (PPZHL) të Programit Rajonal të Këshillit të Evropës për Trashëgimi Kulturor dhe Natyrore në Evropën Juglindore.

Ndonëse, projekti PDKK I & II ndoqën një fokusim më specifik në nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi trashëgimor, ai gjithmonë synoi që të mbante lidhjet me programin rajonal për të plotësuar përpjekjet e bëra nëpër shtetet e tjera në rajon. Puna jonë e drejtuar nga trashëgimia krijon platforma ku çështjet e tërthorta që kanë të bëjnë me komunitetet bëhen bashkë përreth veprimeve konkrete, duke dhënë shembuj për llojin e shoqërisë që ne synojmë ta ndërtojmë.

Si rezultat i suksesit të procesit të planit për trashëgiminë në Kosovën Perëndimore, ai u shtri edhe në katër rajonet e tjera të Kosovës.

Zhvillimi i një Plani të Trashëgimisë si koncept u ndikua nga shembulli i suksesshëm i modelit të Këshillit Irlandez të Trashëgimisë, dhe ekspertët nga Këshilli Irlandez për Trashëgimi kanë ndihmuar procesin e formësimit të Planeve të Trashëgimisë si dhe në ofrimin e mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve të akterëve lokal. Zbatimi i planit për trashëgiminë në katër rajonet bazohet në metodologjinë e dëshmuar në Kosovën Perëndimore që përfshin angazhimin e komunitetit, mbledhjen e të dhënave, vlerësimin e fizibilitetit, pilot veprimet, përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve, përgatitjen dhe zbatimin e planit të trashëgimisë.

Një qasje sistematike, analitike dhe e strukturuar u miratua bazuar në pikat e forta lokale, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet në lidhje me zhvillimin e nismave të qëndrueshme të orientuara nga trashëgimia dhe turizmi në rajon. Pilot veprimet që u zhvilluan njëkohësisht në rajone dhanë një kontribut domethënës në formësimin e planit të trashëgimisë.

Strategjia bazë përfshin integrimin e e nismave të orientuara nga trashëgimia dhe zhvillimi i turizmit trashëgimor me zhvillimin e sektorit të përgjithshëm të turizmit në rajon.

Strategjia përqendrohet në ngritjen e vetëdijes, arsimim, trajnime dhe veprimet e sugjeruara në raport me trashëgiminë kulturore dhe natyrore, dhe adreson çështje praktike duke përfshirë mbledhjen/miratimin në vazhdimësi të të dhënave, konservimin e lokaliteteve, restaurimin, shënjimin, informacionin për trashëgiminë dhe sigurinë e lokaliteteve, të gjitha përmes një partneriteti të lehtësuar dhe procesit të bashkëpunimit që përfshin të gjithë akterët qendror, komunal, të komunitetit, trashëgimisë dhe turizmit në rajon.

Procesi ka qenë i bazuar në partneritet, bashkëpunim dhe pronësinë e komunitetit, dhe në Kosovën Jugore partnerët kyç kanë qenë OJQ-të Ec Ma Ndryshe, Omladinski Savez Gore (OSG), Katedra Slobodnog Uma (KSU), dhe Durmish Asllano, që kanë punuar me të gjitha komunitetet.

Plani i Trashëgimisë përmban tetë pjesë, që theksojnë thelbin e trashëgimisë në zemër të jetës së komunitetit, duke ofruar një pasqyrë të trashëgimisë së rajonit, duke prezantuar idenë e trashëgimisë dhe një plan për trashëgiminë, dhe duke përshkruar se si u zhvillua ky plan për trashëgiminë. Më tutje, ai pasqyron ndrsyhimin në qëndrimet dhe qasjet e e akterëve lokal si rezultat i procesit, dhe thekson konsideratat strategjike në procesin e zhvillimit. Në fund, ai vendos objektivat dhe veprimet e tyre të ndërlidhura e të arritshme me një 'hartë' të qartë se si të zbatohet plani në ndërkohë që ofron shkurtimisht pikat kryesore nga secila komunë në rajon në raport me planin e trashëgimisë.

Përpjekjet e projektit të PDKK-së për të theksuar lidhjen organike në mes të trashëgimisë dhe diversitetit pasqyrohen duke minimizuar dallimin në mes trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale dhe trashëgimisë natyrore përmes një qasje të tërësishme, pjesëmarrëse dhe të integruar ku të gjitha komunitetet kanë zërin dhe vendin e tyre. Ai gjithashtu nxit përfshirjen e arteve bashkëkohore si një formë e shprehjes së trashëgimisë, diversitetit dhe identiteteve të shumëfishta të rajonit. Kjo është thelbësore për përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Në projektin e PDKK-së, ne besojmë se ky Plan Rajonal i Trashëgimisë do të ketë një ndikim domethënës në zhvillimin lokal të Kosovës Jugore, që gradualisht do të çojë tek Plani i Trashëgimisë të Kosovës dhe prezantimin si një shembull pozitiv për rajonet e tjera në Evropë.

Hakan Shearer Demir
Udhëheqës i ekipit të PDKK

Terry O'Regan
Ekspert nga Këshilli i Evropës

FALËNDERIMET

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë akterët që morën pjesë aktive në zhvillimin e këtij plani, në veçanti:

- Anëtarëve të komuniteteve të gjashtë komunave
- Vullnetarët e Komunitetit
- OJQ-të: Ec Ma Ndryshe, Durmish Asllano, Omladinski Savez Gore, Katedra Slobodnog Uma
- Grupet Punuese Ndër-Komunale të PDKK-së në Prizren dhe Suharekë si dhe Malishevë dhe Mamushë
- Anëtarët e Grupeve Punuese Rajonale të PDKK-së
- Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren
- Kryetarët e Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Rahovecit, Dragashit dhe Mamushës
- Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve – personin kontaktues për Zhvillim Lokal

Ekspertët të cilët kontribuan në zhvillimin e planit gjatë fazave të ndryshme

- Terry O'Regan, Irlandë, ekspert nga KiE
- Liam Scott, Këshilli i Irlandës për Trashëgimi
- Julija Trichkovska, PDKK (specialiste mbi trashëgiminë kulturore)
- Valmira Gashi, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Fadil Bajraktari, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës
- Nora Arapi, QRTK në Prizren

Organizatrat partnere që me mirësjellje mbështetën procesin e zhvillimit të kapaciteteve

- Këshilli Irlandez i Trashëgimisë, Irlandë

Koordinatorit të PTD-Jug

- Flaka Xërxa

Koordinatorit për Zhvillim Ekonomik Lokal të PDKK-së

- Harmonije Radoniqi

Lista e Shkurtesave

BIOFOR-IQC	Kontrata e cilësisë për Biodiversitet dhe Pylltari me afat të pacaktuar
LTK	Ligji për Trashëgiminë Kulturore
CHwB	Trashëgimia Kulturore pa Kufi
KiE	Këshilli i Evropës
SIRK	Studimet Integruese Rajonale Krahasuese
OShC	Organizata e Shoqërisë Civile
PE	Partneriteti Evropian
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
ERA	Grupi Përgjegjës Mjedisor
BE	Bashkimi Evropian
EU CARDS	Asistenca e Komunitetit të Bashkimit Evropian për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
PBB	Produkti i brendshëm bruto (PBB)
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
GPNM	Grupi Punues Ndërministror
PTD	Programi i trashëgimisë dhe i diversitetit
RRKT	Rrjeti i Komunitetit të Trashëgimisë
GPNK	Grupi punues ndër-komunal
PPZhL	Pilot Projekti për Zhvillim Lokal
ZHEL	Zhvillimi ekonomik lokal
LPH	Ligji për Planifikimin Hapësinor
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MASHt	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Departamenti i Turizmit)
MTT	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PDKK	Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë
QRTK	Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore
VK	Vullnetarët e Komunitetit
GPR	Grupi Punues Rajonal
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
USAID	Ajencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar



01

Shtëpia e Musa - Efendi Shehzades, shek. 19, Prizren

TRASHËGIMIA SI VATËR E JETËS SË KOMUNITETIT



1.1 Çka është trashëgimia?

Trashëgimia është gjithçka që kemi trashëguar nga e kaluara duke përfshirë monumentet, objektet arkeologjike dhe objektet e tjera të trashëgimisë, trashëgimia arkitekturore, trashëgimia fetare, flora, fauna, habitatet e kafshëve të egra, gjeologjia dhe topografia, peizazhet, gjenealogjia, muzika tradicionale, lojërat, ngjarjet dhe performancat, folklori, artefaktet popullore, gojëdhënat dhe historia e vendit.

Trashëgimia është një pjesë jetike e identitetit tonë dhe ndjenjës për vend. Ajo është një pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme, dhe një burim i jashtëzakonshëm që kontribuon në mirëqenien e shoqërisë përfshirë punësimin, rekreacionin, shëndetin, të mësuarit dhe kënaqësinë. Vlera shoqërore e trashëgimisë është e pamatshme në raport me ofrimin e fokusit për angazhimin dhe bashkëpunimin e komunitetit, në inspirimin e krenarisë për dukjen e rrugëve dhe peizazheve, dhe inkurajimin që të kujdesemi për mjedisin tonë të përditshëm.

Ekziston një arsytim i shëndoshë ekonomik për të përkrahur trashëgiminë, pasi që nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi trashëgimor në veçanti kanë një rol jetik në ekonominë në zhvillim. Nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi krijojnë punësim dhe të hyra financiare të qëndrueshme kur ato janë të integruara si pjesë e një programi gjithëpërfshirës zhvillimor.

Trashëgimia përfshin elemente materiale dhe jo materiale të cilat pasqyrojnë kulturën dhe kreativitetin e komuniteteve njerëzore që nga kohërat më të lashta, si dhe diversitetin e pasur dhe bukurit e mjediseve natyrore.

1.2 Vlera e trashëgimisë

Në të kaluarën, trashëgimia shpesh është perceptuar gabimisht si një përgjegjësi vetëm e qeverive dhe akademikëve. Mirëpo, krahas pronësisë qendrore të trashëgimisë, ekziston edhe pronësia e komunitetit e mad-

“ Trashëgimia përfshin elemente materiale dhe jo materiale të cilat pasqyrojnë kulturën dhe kreativitetin e komuniteteve njerëzore që nga kohërat më të lashta, si dhe diversitetin e pasur dhe bukurit e mjediseve natyrore. ”



Loja tradicionale "Pehlivanët"

je edhe pronësia personale e trashëgimisë. Shumica e familjeve kanë 'trashëgimi familjare' të pasur në formën e mobiljeve, dekorimeve, librave dhe dokumenteve, fotografive, tregimeve, këngëve, historisë, e madje edhe rrobave të cilat janë kaluar nga brezi në brez. Trashëgimia është një përbërës jetik në programet arsimore në mbarë botën. Andaj, ajo njihet nga të gjitha nivelet e shoqërisë si një gjë me vlerë që jo gjithmonë është e matshme nga aspekti monetar.

Pronësia komplekse dhe vlerat e ndërlidhura të trashëgimisë mund të shpjegojnë pse ajo është e kërcënuar aq shpesh. Vlerat e saj simbolike nganjëherë mund të rezultojnë në shkatërrim të qëllimshëm në situata të konflikteve. Perceptimi është se mungesa e vlerës monetare mund të rezultojë në shkatërrimin e saj për shkakë të keqinformimit apo përkeqësimit për shkakë të neglizhimit, posaçërisht kur rëndësia e saj nuk është njohur, hulumtuar, identifikuar dhe mbrojtur zyrtarisht nga ndërhyrja dhe shkatërrimi mjedisor. Vetëdijësimi për kërcënimet e tilla ndaj trashëgimisë duhet të ndërtohet në secilën strategji që ka për qëllim vendosjen e trashëgimisë në thelb të sistemit të vlerave të të gjitha shoqërive. Reagimi ndaj kërcënimeve të tilla dhe të kuptuarit e vlerës maksimale të trashëgimisë për të gjithë qytetarët kërkon financimin e duhur dhe një qasje të nduaruarshme për gjetjen dhe arsyetimin e fondeve të nevojshme.

Prandaj është fatmirësi që sot në mbarë botën, trashëgimia e përbashkët ka një vlerë të pranuar dhe të rëndësishme ekonomike në nivelin qendror, komunal dhe të komunitetit si përqëndrim për bizneset e vogla, si një atraksion për turistët, dhe gjithnjë e më shumë për investitorët. Shumica, nëse jo të gjitha, shtetet kanë lokalitetet e trashëgimisë kulturore të rëndësishme ndërkombëtare

- por zakonisht ato janë të pakta në numër dhe përderisa rëndësia e tyre siguron një fluks të vizitorëve, ato zakonisht kanë kufizime të natyrës së kapaciteteve, dhe si të vetme rallëherë ofrojnë bazën për një sektor të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të turizmit trashëgimor në nivel nacional. Andaj, të gjitha komunitetet përparimtare dhe të përgjegjshme kanë një shtysë të fortë për t'u angazhuar në mënyrë proaktive dhe kreative me trashëgiminë e tyre të gjërë.

Ndërmarrja e veprimeve në fushën e trashëgimisë përfshinë identifikimin e vlerave të saj shoqërore, kulturore, të mjedisit dhe ekonomike. Përmes katër hapave bazë, komunitetet mund të:

- identifikojnë dhe regjistrojnë trashëgiminë e tyre,
- të sigurohen se ajo është e mbrojtur,
- të zhvillojnë trashëgiminë dhe peizazhin e tyre,
- ta integrojnë atë në kulturën e jetës së sotme, dhe aty ku është e mundur t'i caktojnë një përdorim të ri të qëndrueshëm në ndërkohë që respektojnë dhe pranojnë përgjegjësinë për t'ia kaluar të paprekur trashëgiminë e tyre brezave të ardhshëm.

Ngjyrosja e fytyrës në fshatin Lubinjë e Ulët



Kjo kërkon një qasje strategjike të strukturuar në nivel qendror, rajonal, komunal dhe të komunitetit dhe është më se e suksesshme dhe e qëndrueshme aty ku është e bazuar në komunitetet lokale që ndajnë trashëgiminë e tyre të çmuar me vizitorët, në vend se të jenë të bazuar vetëm në interesat komerciale duke eksploatuar një burim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si një produkt turizmi.

Qasja e Planit të Trashëgimisë përfaqëson një strategji kornizë praktike por edhe të qëndrueshme për të lehtësuar dhe koordinuar katër veprimet kyçe të identifikuar më lart në mënyrë që të realizohet vlera e plotë e trashëgimisë së përbashkët për shoqërinë.

1.3 Çka është Plani i Trashëgimisë?

Plani i Trashëgiminë është strategji për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, përmirësimin, interpretimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë, dhe zbatohet në nivel qendror, rajonal dhe komunal. Është një plan veprimi real për të cilin është arritur pajtimi, në referim me mekanizmat e dorëzimit dhe kërkesat buxhetore. Në nivelet e ndryshme, veprimet mund të ndërmerren nga një grup apo organ, ose nga një numër i grupeve në partneritet. Në nivel rajonal një plan i trashëgimisë mund të merr formën e një plani të përgjithshëm rajonal strategjik i përcjellë nga një sërë planesh komunale. Në çfarëdo shkalle qoftë, ai duhet të identifikojë prioritetet për veprim nga të gjithë akterët gjatë një periudhe trevjeçare, dhe duhet të përfshijë një mekanizëm për rishikim dhe vlerësim.

Një Plan i Trashëgimisë paraqet mundësinë për të identifikuar qështjet dhe nevojat e trashëgimisë në nivel qendror, rajonal dhe komunal, dhe t'i adresoj ato në nivel lokal. Ai ka për synim të ndikojë veprimet dhe aktivitetet e të gjithë lojtarëve dhe akterëve kyç që kanë të bëjnë me trashëgiminë, dhe për të ngritur vetëdijen për atë trashëgimi, vlerën dhe potencialin e saj. Prandaj është një deklaratë strategjike për atë se çfarë dëshiron të arrijë një popull në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë dhe konservimin e saj gjatë një periudhe tre-vjeçare, por edhe një listë e veprimeve që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike.

1.4 Pse të kemi një Plan të Trashëgimisë?

Ruajtja dhe menaxhimi i trashëgimisë është përgjegjësi jo vetëm e autoriteteve qendrore apo komunave, por e të gjithëve brenda komunitetit. Shpesh ai funksionon më së miri kur ndërmerret si një partneritet që përfshin të gjitha grupet dhe individët e interesuar. Plani i Trashëgimisë është mënyrë e efektshme për arritjen e konsensusin se si të ruhet dhe menaxhohet më së miri trashëgimia në bashkëpunim duke u përqendruar në një sërë energjish dhe nismash të përbashkëta për të mirën e asaj trashëgimie dhe komuniteteve pjesëmarrëse. Ai është një mekanizëm bashkërendues i cili ofron një kontekst strategjik për veprime të përbashkëta, për t'u siguruar se përfitimet më të mëdha i janë dhënë burimeve të trashëgimisë.

Përpjekjet dhe nismat e grupeve lokale dhe autoriteteve qendrore mund të gjejnë një kontekst më të gjerë përbrenda Planit të Trashëgimisë dhe të lehtësojnë arritjen e

“ Plani i Trashëgiminë është strategji për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, përmirësimin, interpretimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë, dhe zbatohet në nivel qendror, rajonal dhe komunal. ”

marrëveshjes mbi identifikimin e prioritetëve për shpërndarjen e fondeve në dispozicion për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

1.5 Kujt i dedikohet Plani i Trashëgimisë?

Plani i Trashëgimisë është për njerëzit, për të gjitha agjencitë dhe grupet relevante të rajonit si dhe për komunat. Ky plan bazohet në parimin e ndarjes së përgjegjësisë për trashëgiminë dhe të pronësisë ndaj saj.

1.6 Cili është synimi i Planit të Trashëgimisë?

Një Plan i Trashëgimisë synon që të sigurojë benifite për komunitetin lokal përmes rritjes së vetëdijes, vlerësimit, shijimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm, ekonomik apo çfarëdo tjetër të trashëgimisë së tyre kulturore dhe natyrore. Plani gjithashtu mund të përdoret për të fituar mbështetjen e lojtarëve kyç dhe për të krijuar partneritete të reja për mbrojtjen, vetëdijësimin dhe prezantimin e trashëgimisë. Ai ua mundëson një sërë akterësh që të angazhohen në diskutimet mbi rëndësinë e trashëgimisë në lidhje me vlerat e saj globale, kulturore, arsimore, akademike, ekonomike, rekreative, estetike dhe personale, krahas vlerave të saj të brendshme. Plani gjithashtu njihet vlerën e këmbimit të informacionit dhe përgjegjësinë në raport me atë trashëgimi.

Plani për Trashëgiminë bazohet në një qasje të integruar për identifikimin, mbrojtjen, ruajtjen, menaxhimin dhe prezantimin e pasurive të trashëgimisë. Ai duhet të synojë që të përfshijë në mënyrë tërësore aspektet e ndryshme të kësaj trashëgimie, duke shikuar mjedisin historik, natyror, kulturor, social dhe ekonomik si një tërësi, në vend se të tentojë të merret me to në mënyrë të fragmentuar. Ky është një koncept i ri dhe dinamik për trashëgiminë.

1.7 Si është mishëruar koncepti i trashëgimisë në Planin e Trashëgimisë?

Plani i Trashëgimisë është një mundësi për të njohur dhe pranuar praninë e trashëgimisë përreth nesh, në vend se të shihet si diçka që vizitohet vetëm për festa dhe fundjava.

Në paraqitjen e një koncepti të tillë, Plani i Trashëgimisë duhet të trajtojë mjedisin si tërësi, në vend se të kërkojë vetëm të mbrojtë shembujt më të mirë – apo më të dukshëm të trashëgimisë.

Deri sot, legjislati, financimi dhe përpjekjet administrative kanë pasur tendencën që të përqendrohen në mbrojtjen e aspekteve dhe shembujve më të 'rëndësishëm' të trashëgimisë. Përderisa, rëndësia e këtyre lokaliteteve, strukturave dhe llojeve e justifikon mbrojt-

jen e tyre të kujdesshme, Plani i trashëgimisë gjithëashtu njihet trashëgiminë edhe jashtë këtyre zonave të përcaktuara. Ai njihet ndikimin e të kaluarës dhe të njerëzve të saj në çdo aspekt të jetës dhe peizazheve tona, të prekshme në paraqitjen dhe morfologjinë e tyre.

Shpesh pjesa e pacaktuar apo e 'zakonshme' e peizazhit që ofron kontekstin për lokalitetet dhe strukturat e caktuara më të rëndësishme - si nga aspekti i hapësirës, ashtu edhe edhe i domethënies - duke i lejuar ato të kuptohen më plotësisht. Një koncept i tillë i trashëgimisë është më afër parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, që paraqet një të kuptuar më të gjërë të trashëgimisë dhe duke e bërë më relevant për jetët tona moderne. Ai gjithashtu lejon të kuptuar më koherent të mjedisit, ndërveprimet në mes të aspekteve të ndryshme të trashëgimisë, dhe pjesëmarrje më të madhe të publikut në debatet rreth asaj se çka është e rëndësishme, çka duhet mbrojtur, dhe si duhet t'i prezantohet vizitorëve lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një qasje e tillë e tërësishme ndërthet në vete një vështrim më të gjërë të vlerave për t'i futur në debat.

1.8 Çka përmban Plani i Trashëgimisë?

Një Plan i Trashëgimisë rishikon veprimet që mund të jenë ndërmarrë tashmë dhe përcakton një listë të veprimeve të mëtutjeshme të cilat mund të ndërmerren nga një sërë akterësh gjatë një periudhe trevjeçare e cila mbulohet nga plani. Ai përmban një listë të objektivave të gjëra strategjike, ku veprimet e tilla do të ndihmojnë që ato objektiva të arrihen. Përfaqësojë sa të jetë e mundur plani tregon se kush do të kryejë secilin veprim dhe po ashtu mund të tregojë edhe planin kohor për secilin prej këtyre veprimeve. Plani mund të tregojë edhe burimet e mundshme financuese.

Plani i Trashëgimisë jo domosdoshmërisht përfshinë veprimet specifike për një ndërtesë, lokalitet apo vend, apo stabilizimin e një monumenti të caktuar. Në përgjithësi Plani i Trashëgimisë përmban veprimet të cilat pasqyrojnë prioritetet e identifikuar në raport me mbledhjen e të dhënave, ngritjen e vetëdijes, promovimin dhe prezantimin e praktikave më të mira.

1.9 Trashëgimia e qëndrueshme

Aspekti ekonomik i trashëgimisë është shpatë me dy tehe. Mbrojtja, restaurimi dhe menaxhimi i trashëgimisë është një proces i kushtueshëm, dhe pak qeveri në botë i kanë burimet për të financuar punimet e tilla të rëndësishme, përpos kur financimi qendror rritet nga të ardhurat e gjeneruara nga burimi i trashëgimisë. Ndërkombëtarisht, nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi i trashëgimisë janë bërë mekanizma jetik për të gjeneruar të hyra shumë të nevojshme të drejtpërdrejta dhe - çështë më e rëndësishme - jo të drejtpërdrejta për të mbështetur sektorin e trashëgimisë.

Ekziston një treg i rëndësishëm dhe i vërtetuar i turizmit për prodhimet e turizmit të trashëgimisë të prezantuara në mënyrë profesionale dhe të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme. Në shumë vende në zhvillim turizmi në shumicën e rasteve gjeneron mbi 20% të PBB, dhe është burimi kryesor i këmbimit valutor për shtetet me më pak burime ekonomike në botë.

Në Irlandë, një shtet i vogël në disa aspekte i ngjashëm me Kosovën, 40 % e shpenzimeve turistike i atribuohet mjedisit historik. Çdo vit rreth 2.5 milionë njerëz i vizitojnë shtëpitë dhe kështjellat e saj, dhe rreth 2 milionë njerëz i vizitojnë monumentet e saj. Të ardhurat e gjeneruara nga

turizmi burojnë drejtpërdrejt përmes pagesave për hyrje dhe shitjeve të tjera të ndërlidhura të mallrave, por dobia e vërtetë ekonomike buron në mënyrë jo të drejtpërdrejt nga shpenzimi lokal në ushqime, strehim dhe shërbime të tjera.

Sidoqoftë, duhet theksuar se turizmi i qëndrueshëm - kur atraksioni menaxhohet dhe mbrohet tekta vlera e tij realizohet në mënyrë të përgjegjshme - kërkon një qasje të planifikuar që nga fillimi i zhvillimit të produktit të turizmit të trashëgimisë. Gjithashtu duhet pranuar se turizmi i trashëgimisë krijon përdorim dhe dëmtim shtesë të burimeve të trashëgimisë dhe rrit nivelin e nevojshëm për mirëmbajtje dhe kujdes.

Gjithashtu, është thelbësore që të theksohet se sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) ka qenë boshti kurrizor i ekonomisë evropiane, dhe ky realitet është mishëruar në qasjen e këtij plani.

Përderisa korporatat e mëdha kanë tendencën që të eksploatojnë në mënyrë përzgjedhëse dhe intensive lokalitetet kryesore të trashëgimisë në dëm të zhvillimit gjithëpërfshirës nëpër tërë komunitetin e gjerë, sektori i NVM lulëzon në një mjedistë turizmit të trashëgimisë dhe është dukshëm më i qëndrueshëm në një nivel lokal dhe shkallë më të vogël.



Liqeni i Breznës, komuna e Dragashit

02



Pamje piktoreske e urës së gurit në Prizren

TRASHËGIMIA E KOSOVËS JUGORE¹



Plani i Trashëgimisë i Kosovës Jugore, i njohur edhe si rajoni i Prizrenit apo Kosova Jugore, përfshinë territorin e 6 komunave: Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Mamushës, Rahovecit dhe Dragashit. Shumica e popullsisë është etnike shqiptare, përpos banorëve turq me shumicë në komunën e vogël të Mamushës. Grupet e identifikueshme të minoriteteve përfaqësohen nga serbët, boshnjakët, goranët, turqit dhe romët. Qyteti më i madh në rajon është Prizreni, i cili shtrihet rreth Maleve të Sharrit. Ai është qendra administrative e komunës me emër të njëjtë dhe qytetit të dytë më të madh në Kosovë.

Rajoni i Kosovës Jugore është i njohur për bukurinë natyrore të Maleve të Sharrit të cilat krijojnë një kufi natyral me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë. Kufijtë e malit shtrihen nga qyteti i Prizrenit dhe ndjekin dy lumenj, atë të Lumbardhit dhe Lepencit. Një zonë me 147 kilometra katrorë përbën Parkun Kombëtar të Sharrit, të pasur me florë dhe faunë endemike të rajonit, siç është *Pinus Peuce* (Pisha Maqedonase), Pisha e Bardhë dhe Trëndafili i Alpeve. Në zonat më të larta malore gjenden një sërë liqenesh akullnajore. Shkëmbinj të mëdhenj dhe shpella që rrethojnë disa prej zonave ofrojnë një mjedis ideal për rrëqebullin, ariun, dhinë e egër, ujkun, drerin, derrin e egër dhe specie të shpendëve. Peizazhi i mahnitshëm i Liqenit Brezna, rreth 25 kilometra nga qyteti i Prizrenit në komunën e Dragashit, gjatë verës është një destinacion turistik për një numër të madh të vizitorëve nga e gjithë Kosova. Ujërat termal të *Banjës* në Komunën e Malishevës, janë vizituar për një kohë të gjatë si një qendër terapeutike, shëndetësore dhe rekreative.

Një nga burimet kryesore të rajoni është Lumi Lumbardhi, me burimet e tij në shpatet e malit të Prevallës. Në cep të lumit është grykë e pasur me vegjetacion dhe specie bimore relikte. Gjithashtu është vendndodhja e një hidrocentrali (*Prizrenasja*), i ndërtuar në fillim të shekullit të 20-të. Tiparet arkitekturale të fasadave të ndërtesave kryesore imitojnë strukturat gurore të *kullave*, me dritare me korniza drejtkëndore dhe bedena në sipër mureve. Së bashku me ruajtjen e pajisjeve origjinale mekanike në hidrocentral, objekti është shpallur monument kulturor dhe është transformuar në një muze të trashëgimisë industriale.

Projekti i PDKK-së i referohet rajoneve si Veri, Jug, Qendër, Lindje, Perëndim bazuar në përkufizimet e Agjencisë së Zhvillimit Rajonal.

* * *

Sipas artefakteve të zbuluara nga gërmimet arkeologjike të kryera në afërsi të Prizrenit, Dragashit, Rahovecit dhe Suharekës, rajoni ka qenë i banuar qysh në epokën e neolitit. Burimet e shkruara përmendin qytezat e Therandës (sot Suharekës) dhe Petrizenit. I shtrirë në një të dalë shkëmbore 6 km në perëndim të Prizrenit, lokaliteti arkeologjik i Vlashnjës përfaqëson një nga vendbanimet më të pasura shumëshiresore në rajon. Në mesin e shumë gjetjeve, më karakteristike janë fragmentet e poçarisë së ngjyrosur dhe figurat antropomorfike nga periudha e neolitit. Shumë afër lokalitetit, u zbulua një shembull unik i artit në gur që përbëhet nga vizatimi i dy spiraleve të pikturuara në një shkëmb, gjë që sugjeron se vendi është përdorur nga popullsia neolitike për ritualet e kultit. Gjatë Epokës së Antikitetit të Vonë



Kisha e Shën Nikollës, Hoçë e Madhe, ikonostasi, shek. 16

- Mesjetës së Hershme, vendbanimi i Vlashnjes ishte një lokalitet i fortifikuar, i njohur si Gradishta. Një kilometër nga ky lokacion, afër fshatit Poslishtë, janë dokumentuar mbetjet e hanit romak, banja dhe vendbanimeve të tjera romake. Lokacioni ishte një stacion i rrugës antike romake mes Lisusit dhe Naisusit. Gërmimet e kryera në vendbanime të tjera të fortifikuara në afërsi të Prizrenit (si në Korishë) kanë

zbuluar themelet e vendbanimeve dhe fragmente të poçarisë nga epoka e bronzit, si dhe themelet e një kishe të hershme të krishterë e cila konfirmon ekzistimin e vendbanimit gjatë shekujve 4-6 e.s. Dy statuja të vogla nga bronzi të cilat janë gjetur në lokacione të panjohura në qytetin e Prizrenit konsiderohen si kryevepra të artit nga epoka e bronzit. Njëra prej tyre është figura e një femre duke vrapuar, e cila është quajtur "Prizren Maenad" dhe daton diku mes viteve 520-500 p.e.s. e cila sot është e përfshirë në Koleksionin e Antikiteteve Greko-Romake të Muzeut Britanik. Statuja tjetër një figurë zoomorfike e cila daton nga shekulli i 6-të p.e.s. e cila paraqet një dhi të ulur, e cila u zbuluar aksidentalisht në zonën periferike të Prizrenit tani është e ekspozuar në muzeun e Vranjës.

I vendosur në brigjet e Lumbardhit, qyteti i Prizrenit mbrohej nga një kështjellë e fuqishme e cila është ndërtuar në kodrën sipër qytetit. Në mesin e mbetjeve të zbuluara nga fortesa mesjetare e cila ndodhej atje, janë identifikuar format e vona klasike. Strukturat e tre sektorëve që përbënin Qytetin e Epërm, Qytetin e Poshtëm dhe Qytetin Jugor, gjenden brenda fortesës e cila ishte në përdorim të rregullt që nga antikiteti i vonë deri në epokën mesjetare, duke vazhduar gjatë periudhës osmane dhe duke pësuar shumë ndryshime gjatë historisë së saj.

Përgjatë zonës së gjerë të komunës së Suharekës janë regjistruar disa lokalitete arkeologjike, në disa prej të cilave janë kryer gërmime kohë pas kohe. Lokaliteti arkeologjik i Reshtanit është i njohur si një vendbanim që daton që nga vitet 4200-3800 p.e.s ku dy ekzistonin dy kultura neolitike (Vinca dhe Danilo Adriatik). Lokaliteti arkeologjik i njohur si *Hisar*, i cili gjendet në një rrafshnaltë të gjerë dhe të sheshtë në mes të qytezës së Suharekës dhe Prizrenit, njihet si një lokalitet i rëndësishëm i popullit dardan. Ai ka ekzistuar që nga epoka e neolitit të vonë deri në epokën e hekurit dhe njihej si një zonë e zhvilluar në epokën e bakrit. Kjo konfirmohet nga shumë artefakte të punuara nga bakri apo hekuri të cilat janë përdorur për kultivimin

e tokës apo për rituale. Nekropoli i Gjinocit, i cili ndodhet 200 metra në të majtë të rrugës nga Suhareka në Prizren, është i shënuar nga një kodrinë (tuma ilire) dhe është një zbulim unik i kulturës dardane i cili është konstruktuar gjatë periudhës së hekurit të vonë, sipas Guidës Arkeologjike të Kosovës. Një lokalitet i ngjashëm arkeologjik u zbulua në afërsi të fshatit Shirokë, 1.5 kilometra në jug të Suharekës, me indikacione të konstruksioneve tipike të varrezave tumule, me formë rrethore dhe ndërtuar me dhe dhe gurë të lumenjve. Byzylykë krahu dhe dore dhe varëse me ornamente mbresëlënëse u gërmuan nga ky nekropol që daton në shekujt 6-8 p.e.s. Vendbanimi i fortifikuar i Kastercit, i cili gjendet 1,5 kilometra në veriperëndim të qytetës së Suharekës, kryesisht përfaqësohet nga gjetjet e epokës së bakrit. Ai u rindërtua në kohën e Justinianit dhe u ripërdor si nekropol gjatë periudhës së mesjetës. Themelimi i një kisha të krishterë dhe shumë element karakteristik të stolive dhe mjete pune të hekurit janë gërmuar nga kjo zonë prej rreth 500 metrave katror përreth këtij lokacioni.

Krahas burimit të rëndësishëm të ujit termal në *Banjën* e komunës së Malishevës, kjo zonë është e njohur edhe për lokalitetin arkeologjik të *Trojet e Vjetra*, i cili është një kodër varresh që daton që nga epoka e hekurit. Gjetje interesante të stolive janë dëshmi e ripërdorimit të saj gjatë mesjetës së hershme.

Afër rrjedhës së lumit të Drinit të Bardhë, përreth zonës së Çiflakut në komunën e Rahovecit, janë gërmuar dhe paraqitur themelet e një banje romake, që daton diku mes shekujve 2 dhe 4 të e.s. Sipër Zatriqit (e njohur si Gradishta) dokumentohet një vendbanim shumë shtresor nga epoka e hekurit dhe periudha e antikitetit të vonë/mesjetës. Në mesin e mbetjeve të këtij vendbanimi të fortifikuar janë zbuluar simbole dhe shenja të vizatuara të cilat, sipas hulumtuesve, janë tipare karakteristike të artit të gurit që është krijuar shtatë mijë vjet më parë. Dy lokalitete arkeologjike

të regjistruara në territorin e komunës së Dragashit - strukturat e fortifikuara të Krushevës dhe Brrutit - paraprakisht janë datuar të jenë nga periudha e neolitit dhe antikitetit të vonë-mesjetës.

* * *

Që nga vitet 830 i tërë rajoni ishte pjesë e Perandorisë Bullgare. Në vitin 1208, rajoni u pushtua nga Princi i Madh Stefan Nemanja II, dhe gjatë dy shekujve në vijim përbënte një pjesë integrale të shtetit serb të mesjetës.



Vazo kult e gjetur në Reshtan, komuna e Suharekës, koha e Neolitit (foto:MKRS)

Monumenti më i famshëm i mesjetës në rajon është *Kisha Levishka e Virgjëreshës së Shenjtë* e cila ndodhet në qytetin e vjetër të Prizrenit, dhe e cila besohet të jetë ndërtuar në themelet e një tempulli romak. Kisha u rindërtua në vitet 1306-1307 nga Mbreti Milutin dhe u bë një ndërtesë me pesë shtigje: një kombinim i bazilikës origjinale me tre shtigje dhe një kishë në formë kryqi me pesë kube me shesh pushim të jashtëm dhe kambanore me dy nivele sipër. Afresket u pikturuan nga punëtorja e Salonikës nën udhëheqjen e Michael Astrapa. Skenat e Kremtes së Madhe, Pasionit të Krishtit, Mrekullive dhe Shëmbëlltyrat, jeta e Shën Nikollës, si dhe pamjet individuale të shenjtorëve të krishterë dhe përbërja e familjes mbretërore dominojnë naosin e kishës. Këto piktura në mure përfaqësojnë arritjet e artit të Oborrit të Bizantit nga fillimi shekullit të 14. Kjo kishë që nga viti 2006 figuron në Listën e Trashëgimisë Botërore në

Rrezik të UNESCO-së.

Në vitet 1331-32, një nga fisnikët e Prizrenit, Dragoslav Tutiq dhe gruaja e tij Bela, ia dhuruan ndërtesën dhe dekorimin *Kishës së Shën Nikollës* ("Kisha Tutiq") e cila ndodhet në qendër të Zonës Historike të qytetit, në të ashtuquajturën zona e *Papasçarshisë*. Një tjetër kishë e ndërtuar në të njëjtën kohe (rreth viteve 1330), gjendet afër në zonën e Nënkalasë dhe i dedikohet Shpëtimtarit të Shenjtë, dhuratë e një fisniku lokal, Mladen



Ibrik me dy dorëza nga lokaliteti arkeologjik, shek. 8 deri shek. 6 para Erës sonë, komuna e Suharekës (foto:MKRS)

Vladojeviq Brendia u pikturua në vitin 1335 nga i njëjti artist i cili ishte përgjegjës për dekorimin e afreskeve të Kishës së Tutiqit, dhe u përfundua një dekadë më vonë nga piktorë të tjerë lokal të cilët ishin mjeshtër të edukuar në artin tradicional bizantin.

Rrënojat e *Manastirit të Kryeengjëlve të Shenjtë* gjenden 2.5 kilometra në juglindje të Prizrenit. Kompleksi i manastirit përbëhet nga një kështjellë në majën e një kodre në afërsi i cili shërbente për mbrojtjen e tij. Brenda kompleksit ishin dy kisha që i dedikoheshin Kryeengjëlve të Shenjtë dhe Shën Nikollës, të dy të ndërtuar në stilin arkitektural të Rashkës. Pas vdekjes së perandorit Dushan në vitin 1335, ai u varros në një varrezë e cila gjendej në pjesën jugperëndimore të neftit të Kishës së Kryeengjëlve të Shenjtë gjë që ishte një risi unike në atë kohë. Sipas Kartës Themeluese të Perandorit, ai ia dhuroi manastirit 93 fshatra, një minierë të hekurit në Toplicë, tokë pjellore dhe vreshta. Të ardhurat e tregut të pasur të Prizrenit po ashtu i takonin manastirit.

* * *

Ushtria e Perandorisë Osmane e pushtoi qytetin e Prizrenit në vitin 1455. Përkundër ardhjes së kohëve të vështira për popullsinë e krishterë, tradita ndërtuese e kishave ortodokse vazhdoi pasi banorët ishin në gjendje që të siguronin fonde në mungesë të sunduesve të krishterë apo familjeve krishtere fisnike të pasura për të përkrahur projektet e tilla. Ekzistojnë dëshmi materiale dhe të shkruara se shumë kisha u ndërtuan gjatë mesjetës në Rahovec dhe Hoçë të Madhe. Shtrirë në fushat e vreshtave në mes të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare) dhe Maleve të Sharrit, popullsia e këtyre zonave është marrë me prodhimin e verës me shekuj të tërë. Kulmi i zhvillimit të Hoçës së Madhe u arrit në Mesjetë kur serbët lokal ndërtuan rreth 20 kisha dhe dy manastire. Vreshtat e Hoçës së Madhe i takonin Manastirit të Deçanit murgjit e të cilit edhe sot e kësaj dite shfrytëzojnë bodrumet e njëjta antike të verës për prodhimin dhe ruajtjen e saj. Në mesin e disa prej monumenteve të ruajtura, kishat që i dedikohen Shën Gjonit dhe Shën Nikollës, të ndërtuara në shekullin e 14 dhe ripikturuar në kohën e dominimit osman, mund të përmenden si shembuj të jashtëzakonshëm të traditës pikturose post-bizantine në Ballkan. Besohet se Kisha e Shën Nikollës e shekullit të 14, e cila gjendet në varrezat e Hoçës së Madhe, u ndërtua nga prindërit e një pronari lokal të tokave, Gradislav Sushenica. Portretet e ruajtura të kulteve lokale nga koha e ndërtimit të kishës dëshmojnë traditat e ruajtura lokale, përderisa ciklet e pasura të shenjtorëve, si Akathisto i Virgjëreshës së Shenjtë dhe jeta e padronit të tij, Shën Nikollës, pikturuar në shekullin e 16, janë dëshmi e piktorëve të mirë arsimuar në teologji.

Disa kisha rurale, të ruajtura në fshatrat e Mushnikovës, Bogoshevcit dhe Drajçiqit kanë arkitekture tipike fetare të shekujve 16 dhe 17. Ato janë struktura të vogla me një shteg me program klasik ikonografik të pikturave të mureve, të cilat përfaqësonin tem-

at kryesore të Dhiatës së Vjetër dhe të Re, skenat e Jetës dhe Pasionit të Krishtit, si dhe portretet e shenjtorëve me rëndësi ekumene. Kisha e Shën Gjergjit e cila i takon llojit të njëjtë të ndërtesave fetare është dhuratë e vëllezërve Runoviq, e cila u ndërtua në mes të shekujve 14 dhe 16, dhe e cila ndodhet në Zonën Historike të Prizrenit, në oborrin e Kishës Episkopale të shekullit të 19 e cila i është dedikuar shenjtit të njëjtë. Punimet më të fundit të restaurimit ia kanë kthyer shkëlqimin e ikonave, të cilat janë punuar nga një piktor mjeshtrë lokal në shekullin e 17.

Pas pushtimit të Prizrenit nga ushtria osmane, një rajon më i gjerë u organizua administrativisht në një sanxhak (*sançagi*), i cili u njoh si Sanxhaku i Prizrenit, kurse vet qyteti i Prizrenit ishte kryeqyteti i tij. Disa shekuj më vonë, për shkak të pozitës së tij strategjike, politike dhe ekonomike, Sanxhaku i Prizrenit u shndërrua në pjesën qendrore të Vilajetit të Prizrenit (1871), dhe më vonë pjesë e Vila-jetit të sapoformuar të Kosovës (1877).

Monumenti i parë i kulturës osmane - Namazxhah Kërëk ("Xhamia e Thyer"), e cila gjendet afër rrugës kryesore Prizren-Gjakovë u ndërtua menjëherë pas pushtimit të qytetit (1455) nga Isa Beu, komandanti i armatës së Fatih Sulltan Mehmetit, me qëllim që të shërbejë për ritualet fetare të armatës osmane gjatë pushtimit të këtij territori. Në periudhën e saj të hershme të sundimit osman shumë shpejt u ndërtuan dy xhami: Xhamia e *Suzi Çelebisë* (1513) dhe Xhamia e *Kukli Mehmet Beut* (rreth 1535), e cila kryesisht shërbente si teqe. Sipas shënimit në portën kryesore të xhamisë, ajo u rindërtua në vitin 1897 nga Mehmet Beu.

Një nga monumentet më mbresëlënëse të shekullit të 16 është kompleksi i ndërtesave që gjenden përreth *Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës*, e cila u ndërtua në mes të viteve 1563 dhe 1575. Kompleksi përbëhet nga një xhami, tyrbe, medrese, bibliotekë, *dershane* (dhomë mësimi), hamami dhe ndërtesa të tjera mbështetëse të cilat zakonisht ndërtoheshin si qendra fetare dhe

arsimore në qytetet e zhvilluara osmane. Kompleksi i Xhamisë së Mehmet Pashës ka rëndësi të madhe historike për shqiptarët sepse ishte vendi ku u themelua lëvizja kombëtare shqiptare - Lidhja e Prizrenit - në vitin 1878. Flamuri i saj u vendos në ndërtesën e xhamisë kështu që popullsia lokale e quajti xhaminë *Bajrakli* ("bartëse e flamurit"). Ndërtesa e meremetuar rishtas, e cila fillimisht shërbente si *dershane* (dhomë mësimi), tani funksionon si muze (Muzeu i Lidhjes së Prizrenit). Tyrbja, e cila gjendet në oborrin e xhamisë, ishte menduar të shërbente si shtëpia e përjetshme e themeluesit të saj, por Mehmet Pasha vdiq diku në Panoni (Hungari) dhe u varros atje. Sot ajo përdoret si bibliotekë e dorëshkrimeve orientale. Shënimi në pllakën e mermertë sipër hyrjes kryesore të ndërtesës tjetër në kompleks, Hamamit të Mehmet Pashës, tregon se është ndërtuar në kohën kur u ndërtuar xhamia dhe u meremetua në vitin 1883. Që nga viti 2000, zonat e "ftohta" të këtij çifte hamami shfrytëzohen për organizime të ndryshme kulturore.

Një tjetër objekt hamami, i cili u ndërtua në fund të shekullit të 15, sot është selia e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. Është e ditur se në mesin e shekullit të 19 hamami nuk shërbente për funksionin e tij të caktuar pasi Eshref Pasha e ndërtoi një sahat kullë në maje të pjesës së tij të "ngrohtë".

Me pozitën e saj dominuese në qendër të Zonës Historike të Prizrenit, *Xhamia e Sinan Pashës*, e ndërtuar në vitin 1615 nga një donacion i Sofi Sinan Pashës - një person i njohur dhe i arsimit mirë, i cili mbante pozita të rëndësishme në administratën osmane - është



Zeja e filigranit, Prizren

monumenti fetar më përfaqësues i periudhës osmane në Prizren. Ndërtesa u ndërtua me gurët e lumit të lidhur me llaç gëlqereje, dhe me fasadë të jashtme me gurë të gdhendur të cilët supozohet të jenë nxjerrë nga rrënojat e Manastirit të Kryeengjëjve të Shenjtë. Pikturat e dekorimit të brendshëm, të cilat janë punuar në kohën e ndërtimit të saj dhe që janë shtuar më vonë në shekullin e 19, janë me motive lulësh. Dekorimi me mermer është përdorur në sipërfaqen e strukturës në *mahvil* dhe *minber*. Në pjesën veriore të xhamisë është një shatërvan mermeri i dekoruar i cili përdoret për ritualet fetare. Gjatë konstruktimit të xhamisë, në pjesën qendrore të sheshit të qytetit, u instalua një shatërvan për të ofruar freskim dhe një pikë mbledhjeje për artizanët dhe tregtarët që punonin apo tregtonin në tregun dikur të famshëm të Prizrenit. I ndërtuar me mermer të hirtë të latuar, me dekorime gjeometrike në pjesën e sipërme të formës së tij tetëkëndëshe, sot shatërvani konsiderohet si një prej simboleve kryesore të qytetit.

Karakterit orientalisht i Prizrenit të Vjetër mund të njihet nga strukturat e tjera të ruajtura apo meremetuara, kryesisht ndërtesa banimi apo komerciale. Kjo përfshin Teqen e Halvetive, të ndërtuar në shekullin e 17 dhe meremetuar në vitin 1835, një kompleks ndërtesash të karakterit fetar dhe edukativ me dekorime të mrekullueshme të qeramikës të cilat janë përdorur në brendësinë e dhomës. Po ashtu, gjenden edhe disa shtëpi të tregtarëve të pasur të cilat përfaqësojnë arkitekturën tradicionale urbane orientale, duke përfshirë shtëpinë e familjes Shehu, e cila gjendet afër teqesë; shtëpia e Musa-Efendi Shehzades (sot, Muzeu Etnografik), e cila gjendet në pjesën e banuar të qytetit; "Saraji i Vjetër"; shtëpia e Adem Agë Gjonit, e cila gjendet në kufirin perëndimor të Zonës Historike; dhe shtëpia e familjes Pomaku, e cila gjendet në lagjen e vjetër të Saraçëve. Këto janë shtëpi të mëdha dy e tri katesh me fasada karakteristike balllore të dritareve të pozicionuara simetrikisht dhe ballkone të hapura të drunjta (çardak), përderisa brendia është e dekoruar me orendi të gdhendura nga druri.

I vendosur në kryqëzimet e rrugëve të

rëndësishme të tregtisë, qyteti i Prizrenit u bë qendër tregtare në mesjetë dhe rrjedhimisht u zhvillua në një qytet të madh, i cili njihej mirë nga tregtarët e Kotorrit, Dubrovnikut, Venedikut dhe Gjenovës. Një nga zanatet më të vjetra dhe më të popullarizuara që u zhvillua në Prizren ishte ai i tabakëve (përpunimit të lëkurës). Një kompleks i objekteve për përpunimin e lëkurës, i njohur si *Tabakhana*, u ndërtua në bregun e djathtë të Lumit Lumbardhi. Objektet kryesore të kompleksit të *Tabakhanes* ishin disa punëtori të lëkurës dhe një mulli i cili nuk ekziston më. Zanati tjetër për të cilin është i njohur Prizreni edhe sot e kësaj dite është filigrani, i cili përdorur fije të metaleve fisnike, kryesisht argjendit, për të prodhuar vepra arti me forma dantellash jashtëzakonisht të ndërlikuara dhe të bukura. Burimet historike sugjerojnë se filigrani arriti në Kosovë gjatë shekullit të 15.

Si një qendër e rëndësishme administrative, tregtare dhe kulturore në fund të shekullit të 19, Prizreni u bë edhe me një ndërtesë moderne të komunës - *Belediye* - e cila gjendet në lagjen e *Tabakhanës*. Shtëpia dykatëshe është një shembull unik i stilit neoklasik të ndërtesave publike të cilat mund të hasen nëpër qytetet e vona urbane osmane si pasqyrim i arkitekturës evropiane të kohës.

Në vitin 1871, në afërsi të Kishës Episkopale të Shën Nikollës u themelua një Shkollë e Priftërinjve (Shkolla Teologjike Ortodokse), një monument i spikatur në qendër të qytetit të vjetër të Prizrenit, i ndërtuar dhe dekoruar në periudhën mes viteve 1856 dhe 1887. Kisha është një ndërtesë monumentale me një kube në kryqëzimin e navës dhe transeptit, me një narteks me galeri dhe kambanore në pjesën perëndimore. Ikonostasi luksoz i gdhendur në dru u punua nga mjeshtrit e punëtorisë së famshme të Dibrës. Vlen të theksohet se ndërtesa përfaqësuese e shtëpisë së mysafirëve e cila gjendet në oborrin e kishës shërbente si selia e konsullit rus në fund të shekullit të 19.

Ndërtesat e arkitekturës tradicionale vernakulare të ndikuara nga arkitektura osmane

dhe përfaqësuar në veçanti nga tipi karakteristik i banesave me "çardak" ende mund të haset në zonat rurale të rajonit. Një prej tyre, sot e rrënuar, gjendet afër fshatit Llopushnik në rrugën në mes të Dragashit dhe Prizrenit, dhe funksiononte dikur si han. Në Zlipotok (në komunën e Dragashit) dhe në Hoçë të Madhe ekzistojnë edhe sot komplekse të ruajtura të ndërtesave tradicionale të punuara me gur, drunj dhe llaç, me organizimin specifik të hapësirës së murosur që është përdorur për të jetuar dhe për të mbajtur bagëtinë.

* * *

Trashëgimia komplekse e këtij rajoni,

që është gjeneruar nga komunitetet e ndryshme etnike dhe fetare të cilat kanë bashkëjetuar për shekuj me radhë, është dëshmi e përzierjes së kulturave dhe zakoneve. Sot e kësaj dite mund të hasen objekte të mrekullueshme të filigranit, dikur një zakon shumë i popullarizuar në tregun e Prizrenit të Vjetër të cilat janë punuar nga mjeshtrit shumë të zot. Kostumet e pasura me dekorime dhe ritualet e rajonit të Hasit të cilat u prezantuan në Festivalin Popullor Hasi Jehon, lojërat tradicionale si gara e mundjes së *Pehlivanëve* dhe garat me kuaj që zhvillohen në Dragash, ritualet tradicionale të dasmave që praktikohen ende, dhe këngët e bukura *Balada* të komunitetit Goran janë pjesë e tra-



Veshje tradicionale



Zeja e filigranit, Prizren



Performancë tradicionale, festivali "Hasi Jehon" në Dragash

03



Hamami i Gazi Mehmed Pashës, shek. 16, Prizren



ZHVILLIMI I NJË PLANI TË TRASHËGIMISË PËR KOSOVËN JUGORE



3.1 Drejt planit të trashëgimisë – Hulumtim dhe Vlerësim

Plani i Trashëgimisë u zhvillua si një rezultat i komponentit të projektit të PDKK-së mbi Zhvillimin Ekonomik Lokal, fillimisht në rajonin e Kosovës Perëndimore si pilot veprim dhe më pas i zgjeruar në rajonet e tjera gjatë viteve 2013 dhe 2014. Procesi i Planit të Trashëgimisë përqendrohet në menaxhimin e trashëgimisë dhe nismat e orientuara nga trashëgimia/zhvillimi i turizmit, që me efikasitet bashkon një sërë të aktiviteteve të angazhimit të komunitetit dhe pilot projekteve në një strategji të integruar për rajonin, ku një fazë fillestare dyvjeçare e zhvillimit i ka vënë themelet për zbatimin e një plani të veprimit gjatë tri viteve vijuese.


Metodologjia e suksesshme (siç është zhvilluar në Kosovën Perëndimore) është strukturuar në pesë faza:

1. Faza e diagnozës
2. Studimi i fizibilitetit
3. Veprimet pilot
4. Plani për Menaxhimin e Trashëgimisë Rajonale dhe Nismat e Orientuara nga Trashëgimia/Zhvillimi Ekonomik Lokal
5. Paraqitjen dhe instalimin e Programit të Trashëgimisë dhe Diversitetit dhe koordinatorëve të tij

Progresi i projektit i përgjigjet dinamikës së rajonit, ku theksi i procesit është mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore si dhe potencialin e saj përkatës për zhvillim duke përfshirë turizmin e drejtuar nga trashëgimia.

Prioritet gjatë gjithë procesit është angazhimi i komuniteteve me trashëgiminë e tyre të përbashkët me anë të ngritjes së vetëdijes, promovimit, arsimimit dhe aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve.

Rrjedha e aprovuar e punës përfshinte veprimet në vijim:



Faza e diagnozës fillestare përfshinte një grumbullim në shkallë të gjerë të të dhënave dhe studimin nga entitetet e ndryshme, të prezantuara në një aplikacion për një bazë të dhënash 'online' i cili është dizajnuar nga një ekspert lokal.

I. MKRS dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturorë siguruan:

1. MKRS - Departamenti për Trashëgimi Kulturorë siguroi listën zyrtare të trashëgimisë kulturore të paluajtshme në rajon e cila është nën mbrojtjen e Ligjit për Trashëgimi Kulturorë.
2. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren siguroi të dhënat në lidhje me trashëgiminë e përzgjedhur kulturore të paluajtshme të rajonit.

II. Ekspertët e MMPH-së ofruan:

Të dhënat në lidhje me monumentet dhe zonat e mbrojtura natyrore në rajon.

III. OJQ Ec Ma Ndryshe ofroi:

1. Informacion mbi gjendjen e tanishme të monumenteve/lokaliteteve të përzgjedhura kulturore dhe natyrore.
2. Kjo OJQ prezantoi elementet e njohura të trashëgimisë kulturore jo materiale.
2. Dokumentimi me fotografi dhe video i aktiviteteve të raportuara mbi trashëgiminë kulturore të paluajtshme dhe jo materiale dhe trashëgiminë natyrore.

Studimi i fizibilitetit vlerësoi të dhënat e grumbulluara, dhe konfirmoi strategjitë dhe mundësitë e identifikuar të cilat mund të ndiqen për të realizuar në mënyrë të qëndrueshme vlerën e trashëgimisë së pasur të rajonit në aspektin social, kulturor, arsimor dhe ekonomik. Për më tepër, të dhënat e grumbulluara nga organizatat e tjera gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë OJQ-në CHWB (TKPK), u përfshinë gjithashtu në plan.

Veprime pilot u ndërmorën paralelisht me fazat e tjera për t'i informuar me procesin dhe për të përfshirë komunitetet e rajonit që të marrin pjesë aktivisht në këtë proces.

Ky Plan i Trashëgimisë përfaqëson një kornizë pune praktike dhe njëkohësisht edhe të qëndrueshme për të lehtësuar një strategji e cila bazohet në punën e kryer deri më sot, dhe mbështet zbatimin e veprimeve të identifikuara si të dëshirueshme në studimin e fizibilitetit.

3.2 Drejt Planit për Trashëgiminë – Udhëzuesit dhe Puna në terren

Nga përvoja e fituar në rajonin e Kosovës Perëndimore, vlerësimi i kapaciteteve dhe grumbullimi i të dhënave që u zhvilluan në Kosovën Jugore gjatë vitit 2013, dhe udhëhequr nga përfundimet e dala të studim fizibilitetit, ekipi i projektit të PDKK-së, gjatë punës me komunitetet e rajonit, identifikoi veprime të cilat synojnë që të realizojnë potencialin e trashëgimisë së Kosovës Jugore dhe mjedisit të saj në kontekstin e gjerë të planifikimit strategjik.

Zhvillimi i Planit për Trashëgiminë ka përfshirë angazhimin aktiv të të gjithë akterëve në këtë rajon duke përfshirë edhe OJQ-të lokale, me kontributin e Qendrave për Trashëgimi Kulturore, me referim të posaçëm në themelimin e një inventari aktual të trashëgimisë në pajtim me kriteret e ofruara nga ekipi i projektit të PDKK-së.

Në përzgjedhjen e lokaliteteve dhe pasurive të trashëgimisë për veprimet pilot, e gjithë trashëgimia dhe diversiteti i njohur i rajonit u konsideruan si atraksione të mundshme të cilat mund të nxisnin zhvillimin e “nën-sektorëve alternativ të turizmit”, p.sh. turizmi kulturor, shpirtëror apo eko-turizmi. Kriteret për përzgjedhjen e peizazheve natyrore dhe kulturore dhe monumenteve historike, lokaliteteve dhe traditave të gjalla janë zbatuar në pajtim me vlerësimin e:

- Gjendjes së asetit të trashëgimisë, p.sh. prezantimi i saj para publikut të gjerë.
- Qasja e duhur në asetin e trashëgimisë.
- Disponueshmëria e të dhënave për tiparet e vlerësuara të asetit të trashëgimisë
- Kapacitetet infrastrukturore të rrethinës/mjedisit.
- Interesimi dhe gatishmëria e shprehur nga praktikuesit e tyre për mbrojtjen dhe transmetimin e traditave të gjalla tek brezi tjetër.

Për më tepër, një seri e punëtorive mbi trashëgiminë, që u zhvillua në bashkëpunim me rajonet e tjera, përcjellë nga angazhimi i akterëve lokal në procesimin e planit dhe vendosjen e kontakteve me kolegët e tyre, duke pasur parasysh tablonë e madhe.

“

Ky Plan i Trashëgimisë përfaqëson një kornizë pune praktike dhe njëkohësisht edhe të qëndrueshme për të lehtësuar një strategji e cila bazohet në punën e kryer deri më sot, dhe mbështet zbatimin e veprimeve të identifikuara si të dëshirueshme në studimin e fizibilitetit.

”

Diagrami në vijim pasqyron dobësitë në sektorët e trashëgimisë së rajonit, identifikuar në analizën SWOT e cila u ndërmor si një veprim thelbësor në studimin e fizibilitetit:

TRASHËGIMIA KULTURORE E PALUAJTSHME

- Lokalitetet arkeologjike dhe monumentet jo mirë të prezantuara për publikun e gjerë
- Mungesa e shenjave për lokalitetet arkeologjike dhe trashëgiminë e ndërtuar
- Shenjëzim i varfër në rrugë drejt zonave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Nevojë urgjente për një inventar gjithëpërfshirës të përditësuar dhe të miratuar mbi trashëgiminë materiale dhe peizazheve kulturore
- Nevojë urgjente për masa konservuese në strukturat e ndërtesave në pajtim me prioritetet e caktuara
- Nevoja për një qasje të integruar ndaj trashëgimisë në kuadër të planifikimit hapësinor
- Mungesa e programeve përkatëse të menaxhimit dhe rehabilitimit

TRASHËGIMIA KULTURORE E LUAJTSHME

- Nevojë urgjente për një inventar gjithëpërfshirës të integruar mbi koleksionet e muzeve
- Urgjentisht nevojiten materialet e duhura promovuese
- Nevojë urgjente për një qasje sistematike ndaj konservimit, ruajtjes, ekspozimit dhe interpretimit të koleksioneve të muzeve.

INSTRUMENTET DHE MJETET LIGJORE PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË:

- Rishikimi i Ligjit mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor
- Rregullore përkatëse që burojnë nga Ligji për Trashëgiminë Kulturore
- Udhëzues përkatës që burojnë nga Ligji për Trashëgiminë Kulturore
- Udhëzimet përkatëse për zbatimin e Ligjit mbi Natyrën

TRASHËGIMIA KULTURORE JO MATERIALE

- Mungesa e inventarit
- Materialet promovuese për mënyrat tradicionale të jetesës të komuniteteve mungojnë apo janë jo adekuate
- Pak aktivitete apo performanca të organizuara
- Mbështetje jo adekuate për praktikuesit e zejeve tradicionale, performancave dhe produkteve të ndërlidhura të trashëgimisë kulturore jo materiale.

TRASHËGIMIA NATYRORE:

- Informacion i pamjaftueshëm për burimet e biodiversitetit dhe peizazhit natyror
- Masa jo adekuate për konservim
- Infrastrukturë e dobët për qasje të kënaqshme nga publiku;
- Mungesa e një qasjeje të integruar drejt një menaxhimi dhe planifikimi të peizazhit në të gjitha fushat duke përfshirë vlerën e lartë të zonave të trashëgimisë natyrore
- Infrastruktura e varfër për menaxhimin e përgjithshëm të trashëgimisë natyrore



Rrapi i Marashit, Prizren

04

Teqja e Tarikatit Halveti shek. XVII
Tekija Halveti XVII vek
Halveti Tekkesi XVII y.y.
The Halvet's Tekke XVII c.



Teqja Halvetie, shek.17
(i restauruar në 1835), Prizren

I QËNDRIMEVE DHE QASJEVE



Gjatë rrjedhës së projektit PDKK II, në rajon u zhvilluan një sërë aktiviteteve me përfshirjen aktive të akterëve lokal. Një vlerësim paraprak i vazhdueshëm i cili u ndërмор mbi ndikimin e punës së zhvilluar nga projekti i PDKK-së identifikoi ndryshimin e qëndrimeve dhe qasjeve kundrejt zhvillimit lokal dhe trashëgimisë si burim. Sipas këtyre akterëve lokal, projekti PDKK II kontribuoi në:

- Ndryshimin e qasjes në mesin e OShC-ve dhe OJQ-ve në dëshirën që të veprohet më shumë në nisma rajonale sesa vetëm në veprime lokale.
- Rritja e bashkëpunimit me akterë të shumtë, duke përfshirë partnerët ndërkombëtar, dhe vlerësimi i tyre në metodologji dhe qasje.
- Marrëdhënie të përmirësuara dhe bashkëpunimi në mes të OJQ-ve lokale, komuniteteve, autoriteteve dhe institucioneve lokale, duke përfshirë Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturorë.
- Rritja e interesimit dhe përfshirjes së QRTK-ve në nismat mbi praktikën e trashëgimisë jo materiale, gjë që është jashtë mandatit aktual.
- Rritja e interesimit dhe gatishmërisë së artizanëve lokal që t'u kalojnë dijet dhe mjeshtërinë e tyre brezave të rinj dhe që të ofrojnë punëtori të organizuara për hir të ruajtjes dhe vazhdimin të traditave, dhe jo vetëm të përfitimit financiar.
- Rritja e vetëdijësimit të institucioneve lokale dhe OJQ-ve mbi nevojën e vazhdueshme për zhvillim profesional mbi trashëgiminë kulturore.
- Njohja e rëndësisë dhe fuqisë së veprimeve të vogla dhe domethënëse të ndërmarra nga komunitetet, duke promovuar dhe shfrytëzuar burimet e trashëgimisë për zhvillimin ekonomik lokal.
- Pranimi dhe mbështetja për nisjen e Programit PTD nga të gjithë akterët si një domosdoshmëri për rajonin.
- Të kuptuarit dhe interesimi në platformat e vazhdueshme për dialog dhe bashkëpunim, të cilat u filluan nga Grupi Punues Rajonal, në të cilin janë të përfaqësuara të gjitha komunat.
- Vetëdijësimi dhe gatishmëria e të gjithë akterëve lokal për bashkëpunim me të gjitha rajonet e tjera në frymën e një rrjeti për trashëgiminë.
- Rritja e vetëdijësimit dhe gatishmërisë së akterëve dhe autoriteteve lokale për të lidhur dhe shkrirë aktivitetet e projekteve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare nën një vizion dhe program të përbashkët.
- Rritja e vetëdijësimit se puna për trashëgiminë kulturore dhe natyrore kërkon më shumë angazhim nga komuniteti dhe vullnetarët.
- Të kuptuarit e domosdoshmërisë për një bashkëpunim shumë disiplinor në mes të njerëzve nga sektorë të ndryshëm në rajon krahas ekspertëve nga fusha dhe nivele të ndryshme.
- Shtimi i njohurive dhe vetëdijes në mesin e mësuesve në shkollat fillore për komunikimin e vlerës së trashëgimisë kulturore dhe diversitetit tek nxënësit në moshë sa më të hershme.

05



Ekspozitë në Muzeun Arkeologjik, hamami i Prizrenit nga shek. 15

KONSIDERATAT STRATEGJIKE

Qasje e integruar ndaj planifikimit dhe menaxhimit të trashëgimisë

Zhvillimi i planifikimit dhe menaxhimit të realizueshëm të trashëgimisë në Kosovë, në përputhje me normat dhe standardet evropiane, me theks të veçantë në mirëqenien e komunitetit përmes pjesëmarrjes aktive të të gjitha grupeve të interesit dhe shoqërisë civile, kërkon një qasje të qëndrueshme dhe të integruar.

Qasja e Planit të Trashëgimisë do të lehtësojë përfshirjen e nismave të orientuara nga trashëgimia në kuadër të zhvillimit më të gjerë ekonomik me theks të veçantë në sektorin dhe produktet e turizmit. Strategjia nuk do të përqendrohet vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë materiale/jo materiale kulturore dhe natyrore (duke përfshirë konservimin e lokaliteteve, meremetimin, shënimin, informacionin për trashëgiminë dhe sigurinë e lokaliteteve), por gjithashtu do të përfshijë autoritetet e trashëgimisë që veprojnë në partneritet dhe bashkëpunim me palët e tjera të interesuara dhe akterët e turizmit dhe komunitetit. Ai gjithashtu do të nxis përfshirjen e arteve bashkëkohore në punën për trashëgiminë si një formë e shprehjes së trashëgimisë, diversitetit dhe identiteteve të shumëfishta të rajonit.

Kjo qasje, siç është promovuar nga projekti i PDKK-së, ka potencial që të adresojë kërkesat kontradiktore, duke përfshirë pajtimin dhe integrimin e komuniteteve të ndryshme etnike përmes zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe turistik me dobi të ndërsjellë, përderisa me kalimin e kohës ruhet integriteti dhe përparësia e trashëgimisë kulturore dinamike. Kjo pritje do të varet nga shtypa e momentit komercial si përgjegjësi ndaj ndjeshmërisë së përbashkët përgjatë procesit.

Këto konsiderata strategjike janë të ndërlidhura ngushtë, dhe mbrojtja me sukses e trashëgimisë kulturore në Kosovën e Jugut do të varet nga efikasiteti dhe kohezioni i nivelit të bashkëpunimit që arrihet në mes të partnerëve publik dhe privat. Në mënyrë që mbrojtja të jetë e suksesshme, është jetike që komunitetet lokale të jenë plotësisht të vetëdijshme rreth asaj që është duke u mbrojtur, pse është e rëndësishme, dhe sesi veprimet e njerëzve lokal mund të ndikojnë në mbrojtje. Një plan i shëndetshëm për menaxhimin e trashëgimisë duhet të përqafojë diversitetin, gjë që kërkon një proces të kujdeshëm të dizajnit dhe planifikimit. Asetet e mbrojtura, dizajnuara dhe mbrojtura mirë dhe me një promovim të duhur janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të turizmit trashëgimor.

Korniza e punës e planit për trashëgiminë do të jetë një katalizator i rëndësishëm në arritjen e këtij rezultati të dëshirueshëm përmes një game të qasjeve specifike strategjike.

Rekomandimet për Qasjen Potenciale Rajonale të Integruar

Rajoni Jugor dallon për trashëgiminë e tij të pasur dhe të shumëllojshme materiale, si në aspektin arkeologjik ashtu edhe në atë arkitektural, të shpërndarë në tërë territorin. Përderisa Prizreni është shtëpia e një numri të konsiderueshëm të aseteve të trashëgimisë, të gjashtë komunat e këtij rajoni kanë potencial të madh të trashëgimisë së ndërtuar për të cilin mund të bashkojnë forcat, për ta bërë këtë aspekt të trashëgimisë pjesë qendrore të planit të tyre rajonal. Trashëgimia e ndërtuar do të ishte pikënisja fillestare dhe do të luante një rol jetik në bashkimin e të gjitha aspekteve të trashëgimisë, peizazhit dhe diversitetit në mënyrë që rajoni të prezantohet në mënyrë komplementare me rajonet e tjera të Kosovës, si lokalisht ashtu edhe ndërkombëtarisht. E pranuar nga komunitetet lokale, shoqëria civile dhe autoritetet, prania e theksuar e trashëgimisë së ndërtuar manifestohet si një forcë madhore e rajonit bazuar në punën e thuktë të kryer gjatë përgatitjes së këtij plani. Prandaj, ajo kërkon vëmendjen e merituar në qasjen e integruar që rekomandohet në rajon.

Rrjedhimisht, Plani i Trashëgimisë në Jug rekomandon që palët e interesuara të punojnë drejt një vizioni të përgjithshëm për zhvillimin e rajonit, **ku rajoni paraqet praktika të mira të një qasjeje të integruar duke shfrytëzuar trashëgiminë e ndërtuar si burimin kryesor që siguron pjesëmarrjen demokratike të qytetarëve të vet.**

Ai nxit komunitetet përreth lokaliteteve të përzgjedhura të trashëgimisë (lokalitete të cilat kanë domethënie specifike për shoqërinë dhe kanë një vlerë të përbashkët) që të tregojnë vëmendje të veçantë ndaj zhvillimit dhe menaxhimit të tyre, për të krijuar nisma kreative. Me përfshirjen aktive të komunës dhe të komunitetit, rajoni mund të luajë një rol kyç në revitalizimin e arkitekturës rurale, vernakulare dhe në ndërkohë të siguroj që begatia dhe diversiteti i lokaliteteve historike të mbetet imponues, dhe të tërheq turizmin fetar dhe rural. Ai gjithashtu mund të shfrytëzojë lokalitetet e trashëgimisë materiale për aktivitete, duke i dhënë domethënie dhe vlerë bashkëkohore ekzistencës së tyre sot. Shfrytëzimi i disa lokaliteteve tashmë është në zhvillim e sipër në Prizren (si p.sh gjatë Dokufestit), dhe ka pasur reagim pozitiv ndaj tij

Një qasje e tillë mund të nxjerr në pah komunitetin dhe nismat e orientuara nga trashëgimia nën një 'program rajonal', duke transformuar trashëgiminë lokale në mundësi për popullsinë lokale.

Përmes këtij programi, me praninë e Objektivit për Trajnime Beledije në Prizren, rajoni mund të bëhet frymëzim dhe burim për pjesën tjetër të Kosovës, duke shfrytëzuar mjetet e KiE dhe në linjë me parimet e Këshillit të Evropës dhe Konventën e Valetës dhe Granadës. Bashkëpunimi në krijim e sipër në mes të Universitetit të Prishtinës (dhe Universitetit të Prizrenit), Programit të Junikut, MKRS-së dhe Objektivit Trajnimeve Beledije mund të jetë një burim i rëndësishëm në këtë proces.


Programi rajonal, me një vizion të rekomanduar, mund të fillojë me çdo komunë duke identifikuar dhe përcaktimin e një lokaliteti dhe zhvillimin e ideve rreth tij, duke integruar të gjitha elementet e aseteve të trashëgimisë të orientuara drejt komunitetit. Ky lokacion, që lidhet me rëndësinë e vendit për komunitetin, mund të jetë një ndërtesë vernakulare, një lokalitet arkeologjik apo një monument. Për të pasur sukses, ky proces kreativ duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të kërkojë mendimet e të gjithëve.

Mundësitë e financimit mund të përqendrohen më tutje në partneritetet e kohëve të fundit të cilat janë formuar në rajon në mes të OJQ-ve ndërkombëtare, komunës dhe autoriteteve qendrore, të cilat mund të jenë një mundësi që duhet eksploruar më tutje në mënyrë që komunat të tërheqin fonde shtesë.

Bazuar në lokalitetin e përzgjedhur, secili plan gjithashtu mund të pasqyrojë praktikën e mira të rekomanduara të Zonës së Veçantë të Mbrojtur, nëse është e aplikueshme.

Shembujt e paraqitur në rajon duhet të përfshijnë të gjitha elementet siç janë zhvilluar nga modeli i Junikut dhe mund të frymëzojnë nisma të ngjashme private dhe publike në rajon. (Ju lutemi shiqoni informacionin rreth metodologjive të zhvilluara në rastin studimor mbi Rehabilitimin Urban – Lagjeja e Qendrës Rajonale të Turizmit në Junik, Programin 'Gurët që Flasin' dhe Rasti studimor mbi Konzervimin e Integruar – Bazat e Konzervimit për Qendrën Historike të Prishtinës në Shtojcën 3).

Qasja Gjithëpërfshirëse Rajonale përmes Trashëgimisë së Ndërtuar



5.1. Konsiderimet në konceptimin e një qasjeje të integruar

- **Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve:** Zhvillimi i një plani për ruajtjen dhe mbrojtjen e vendeve, lokaliteteve dhe traditave të veçanta që tërheqin popullsinë lokale dhe një gamë më të gjerë të vizitorëve. Plani duhet të vlerësojë domethënien dhe vlerën e aseteve të trashëgimisë për shoqërinë dhe duhet të jetë në pajtim me të gjitha ligjet/ rregulloret e zbatueshme në nivel lokal dhe nacional në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai gjithashtu duhet të përqendrohet në zhvillimin e nismave për mbrojtjen dhe zhvillimin e peizazheve, si dhe në ruajtjen e praktikave dhe ngjarjeve në përputhje me interesat e individëve, grupeve të njerëzve apo komuniteteve në rajon.
- **Përqendrimi në autenticitetin e lokaliteteve, traditat e gjalla, shprehjet dhe prezantimin efektiv:** Kontributet e brezave të mëparshëm dhe grupeve të ndryshme formësojnë historinë dhe kulturën e një

vendi dhe komuniteti sot, duke e bërë unike dhe një pikë atraksioni për vizitorë. Në mënyrë që të vlerësojmë të tashmen ne duhet ta kuptojmë të kaluarën tonë dhe të gjejmë mënyra krijuese dhe atraktive për ta prezantuar atë në mënyrë që të ndërtohet marrëdhënia në mes të vendeve, individëve dhe komuniteteve, por edhe vizitorëve Autenticiteti i vendeve, njerëzve dhe historitë e tyre i dallojnë ato nga njëra-tjetra si dhe ofron përvoja të dallueshme.

- **Sjellja e lokacioneve në jetë përmes interpretimit cilësor:** Një destinacion është një vend që ka një histori! Shfrytëzimi i metodave krijuese për të interpretuar rrëfimet, lokalitetet e veçanta kulturore, traditat, ngjarjet dhe personalitetet, si dhe bukuritë e mjedisit natyror, e bëjnë komunitetin apo rajonin të dallueshëm. Duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse duke treguar me respekt historinë e të gjitha grupeve që kanë kontribuar në trashëgiminë e përbashkët.

- **Gjetja e baraspeshës në mes të jetës së komunitetit, ruajtjes së trashëgimisë dhe zhvillimit të turizmit:** Një komunitet që çmon dhe mbron trashëgiminë e vet do të kontribuojë në zhvillimin e një projekti të suksesshëm, me fondet, vullnetarët dhe mbështetjen e nevojshme politike. Vetëdijesimi dhe njohuria e komunitetit për ruajtjen e trashëgimisë dhe mundësitë të turizmit janë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm. Vlera specifike e cilitdo aset të trashëgimisë për komunitetin duhet të vlerësohet me kujdes pasi mirëqenia e tyre nuk duhet të sakrifikohet në emër të ruajtjes së trashëgimisë apo zhvillimit të turizmit. Vëmendje e veçantë duhet të tregohet ndaj programeve të baraspeshuara të orientuara nga komuniteti për zhvillimin e peizazheve, në pajtim me rëndësinë e tyre për njerëzit lokal. Një proces gjithëpërfshirës i konsultimeve me komunitet është kyç për një dialog efikas për të gjetur baraspeshën.
- **Përfshirja e grupeve të marginalizuara /komuniteteve:** Prania e grupeve diverse, pa marrë parasysh numrin dhe kohën e pranisë së tyre në një territor, është një aset për shoqërinë dhe nismat e orientuara nga trashëgimia. Secili grup/komunitet e ka sistemin e vet të vlerave dhe kontributin e veçantë në trashëgiminë e përbashkët të një vendi, dhe ai duhet të jetë në gjendje që të ketë vendin e vet të merituar në të gjitha fazat, duke filluar nga veprimet e konceptimit, duke marrë parasysh nevojat, kulturën, besimet dhe mënyrën e tyre të jetuarit. Margjinalizimi i grupeve bazuar në moshën, aftësinë, gjininë, përkatësinë etnike, të kaluarën socio-ekonomike, origjinën e tyre gjeografike, etj. vetëm sa e zgjeron boshllëkun dhe sjell pabarazi, duke i kontribuar tensioneve në mesin e grupeve. Nismat e orientuara nga trashëgimia krijojnë platforma konstruktive dhe duhet të marrin parasysh të gjitha grupet/komunitetet në një territor.
- **Integrimi gjinor:** Integrimi gjinor do të thotë sigurimi i mundësitë të barabarta dhe praktikave jo diskriminuese në zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha politikave. Nëse ka integrim gjinor, të gjitha veprimet do të duhej të planifikohen, zbatohen, monitorohen, të raportohen për to, dhe vlerësohen duke pasur parasysh perspektivën gjinore. Përderisa femrat paraqesin një lidhje të fuqishme sociale në shoqërinë e Kosovës dhe luajnë një rol kyç në bartjen e trashëgimisë tek brezat e rinj, ato janë vetëm pjesërisht të pranuar në tregun e punës dhe pushtetin vendimmarrës në politika dhe veprime të komunitetit. Teknikat me ndikim të drejtpërdrejt pozitiv tek gratë në nivel të shoqërisë si objektivat e projekteve me ndjeshmëri gjinore, buxheti gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor dhe të dhënat e zbërthyer gjinore janë masat më të fuqishme për të promovuar barazinë gjinore përmes veprimeve. Integrimi gjinor dhe promovimi i barazisë gjinore në nismat e orientuara nga trashëgimia duhet të jenë ndër konsideratat kryesore, si një qëllim i qëndrueshëm dhe politik për të drejta kulturore dhe pjesëmarrje demokratike.
- **Bashkëpunimi për qëndrueshmërinë e menaxhimit:** Ruajtja e trashëgimisë dhe zhvillimi i turizmit kërkojnë pjesëmarrjen e individëve dhe organizatave të shumta. Ekziston nevoja për të krijuar partneritete për të zgjeruar mbështetjen dhe gjasat për sukses, për shembull, përmes prezantimit të lokaliteteve dhe aktiviteteve tradicionale në komunitet apo rajon, promovimin e bukurisë natyrore ku qasja dhe infrastruktura i plotësojnë standardet, dhe nxitjen e promovimit të ndërthurur me lokalitete të tjera për të maksimizuar ekspozimin. Këto parakushte janë jetike që turizmi i trashëgimisë të jetë formë e qëndrueshme e zhvillimit ekonomik. Bashkëpunimi në mes të autoriteteve qendrore dhe Qendrave Rajonale për Trashëgimi Kulturorë, si dhe entiteteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit/natyrës, akademitë dhe institucionet arsimore, është thelbësor. Kjo gjithashtu nxit pronarët e trashëgimisë për të kuptuar rëndësinë e të punuarit me autoritetet lokale në konservimin dhe mbrojtjen e burimeve të trashëgimisë teksa zhvillohen mekanizmat për arsimim dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve të trashëgimisë.

5.2. Konsiderimet në planifikimin dhe dizajnimin e një qasjeje të integruar

A- Vlerësimi i potencialit të trashëgimisë - përcaktimi i burimeve aktuale duke përdorur inventarët.

Qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm të bëjë një listë të burimeve por të vlerësojë cilësinë potenciale dhe nivelin e shërbimeve. Krijimi i *inventarëve* është një imperativ në mënyrë që të fillohet me një vlerësim objektiv të aseteve duke përfshirë atraksionet dhe ngjarjet ekzistuese dhe ato me potencial për zhvillim. Rëndësia historike, gjendja fizike e trashëgimisë kulturore të luajtshme, elementet e trashëgimisë tradicionale, atraksionet e trashëgimisë natyrore dhe peizazheve janë të dhëna thelbësore për karakterizimin e lokacioneve, praktikave dhe aktiviteteve në procesin e inventarizimit. Informacioni në inventar ndihmon në identifikimin e kornizës së përgjithshme të punës të një plani zhvillimor për trashëgiminë.

B- Sigurimi i zhvillimit profesional të vazhdueshëm - mbrojtja, mirëmbajtja dhe menaxhimi.

Shqyrtimi i *planeve për mbrojtje, mirëmbajtje dhe menaxhim në mënyrë që të arrihen rezultate afatgjata është një ndër parakushtet e rëndësishme për objektivat zhvillimore për veprime që duhet të theksohen në Planin e Trashëgimisë. Ruajtja e aseteve, mirëmbajtja e trashëgimisë natyrore dhe zonave të peizazhit karakteristik, si dhe mbrojtja e praktikave tradicionale dhe rrëfimeve të kaluara nëpër breza, janë çështje thelbësore për t'u shqyrtuar për të ruajtur karakterin e komunitetit dhe mjedisin e tij jetësor.*

Ruajtja përfshinë prodhimin e përmirësimeve "të prekshme" në lokalitetet historike natyrore apo praktikat dhe ngjarjet tradicionale, sigurimin e mbrojtjes së të gjitha aseteve dhe artefakteve, dhe të treguarit e tregimit të tyre përmes interpretimit.

Hulumtimi është me rëndësi për të hartuar dhe/ose përditësuar informacionin, gjë që do të jetë e domosdoshme gjatë restaurimit të strukturës apo praktikës tradicionale dhe interpretimit të tyre para vizitorëve.

Si proces i kthimit të asetit në një gjendje të shfrytëzueshme përmes riparimit apo ndryshimit i cili mundëson shfrytëzimin efikas bashkëkohor pa e prekur vlerën e tij historike dhe kulturore, *rehabilitimi* pritet që të shqyrtohet në planet e trashëgimisë. Standardet kanë të bëjnë me të gjitha llojet e ndërtesave historike dhe gjithashtu përfshinë tiparet e ngjajshme të peizazheve, mjediseve dhe lokacioneve të trashëgimisë natyrore. Standardet aplikohen në projekte specifike të rehabilitimit duke marrë parasysh fizibilitetin teknik dhe ekonomik.

C- Zhvillimi Ekonomik Lokal përmes Burimeve të Trashëgimisë dhe potencialeve

(Planifikimi për Trashëgiminë dhe Zhvillimi i Industrive Kreative)

Trashëgimia kulturore dhe kapaciteti kreativ si dhe aftësia e njerëzimit për të shpikur gjëra të reja kanë qenë të integruara ngushtë përgjatë shekujve. Në njërën anë, trashëgimia jonë më e vlerësuar shpesh ka qenë rezultat kreativ i kulturave të ndryshme nëpër kohë. Në anën tjetër, trashëgimia kulturore ka shërbyer si frymëzim dhe burim për artistët dhe zejtarët në mbarë botën.

Sot, ndërmarrjet kreative po frymëzohen nga trashëgimia lokale materiale dhe jo materiale, duke siguruar punësim dhe mbështetje për ekonomitë lokale shpesh në lokacione shumë të largëta. Nismat e tilla të orientuara nga trashëgimia përmirësojnë atraktivitetin e zonave për turistët dhe theksojnë vlerën dhe diversitetin e trashëgimisë lokale, teksa jo domosdoshmërisht janë të varura nga tregu i turizmit lokal për të shitur prodhimet e tyre.

D- Ngritja e Vetëdijes dhe Arsimimi i Publikut

Vetëdijesimi për trashëgiminë fillon me arsimimin. Të kuptuarit e asaj që përfaqëson trashëgimia është thelbësor për vlerësimin e problemeve të ndryshme të trashëgimisë në rajon, komunë apo në mesin e komuniteteve.

Një plan i suksesshëm për trashëgiminë ia zgjat dorën komunitetit në mënyrë që të fitojë mbështetje. Si rezultat, njohuria dhe vetëdijesimi për trashëgiminë do të rritet, gjë që më pas do të nxisë anëtarët e komunitetit që të kontribuojnë në përpjekjet për trashëgiminë që janë në vazhdimësi. Ky është një proces ciklik, në vazhdimësi, teksa komuniteti rritet dhe banorët e rinj duan të përfshihen dhe të mësojnë më shumë për identitetin unik të vendit në të cilin ata jetojnë.

Programet Arsimore për Trashëgiminë në shkolla nuk kanë për qëllim vetëm të prezantojnë rëndësinë e trashëgimisë për brezat më të rinj por, gjithashtu edhe që të ngrënë nivelin e përgjithshëm të vetëdijes për trashëgiminë në komunitet, duke nxitur respektin për diversitetin dhe kreativitet për ta shprehur atë më mirë. Artet bashkëkohore luajnë një rol të rëndësishëm për të shprehur trashëgiminë, diversitetin dhe identitetet e shumëfishta të trashëgimisë ku individët dhe komunitetet janë në gjendje që të përkufizojnë vetveten me realitetin e ndryshueshëm të botës së sotme.

“ Vetëdijesimi për trashëgiminë fillon me arsimimin. Të kuptuarit e asaj që përfaqëson trashëgimia është thelbësor për vlerësimin e problemeve të ndryshme të trashëgimisë në rajon, komunë apo në mesin e komuniteteve. ”

E- Angazhimin aktiv i komunitetit dhe pjesëmarrja qytetare

Përderisa masat për mbrojtjen legjislative dhe teknike janë të rregulluara nga autoritetet qendrore dhe lokale, komunitetet luajnë një rol kyç për planifikimin dhe menaxhimin e trashëgimisë në rajonet e tyre përkatëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve është thelbësore për të kuptuar kuptimin e trashëgimisë dhe të tregojnë vëmendjen e nevojshme ndaj rëndësisë së saj në nivel lokal, ku komunitetet kanë shtuar vlerësimin për trashëgiminë e tyre të përbashkët dhe e trajtojnë atë me kujdes dhe respekt. Gjithë planifikimi dhe dizajnimi i planeve dhe projekteve për trashëgiminë duhet të kërkojnë në mënyrë aktive angazhimin e komunitetit dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve me një qasje gjithëpërfshirëse.





*Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit,
Muzeu historik (rindërtuar në shek. 20)*

06

Puntoria e filigranit, Prizren



OBJEKTIVAT DHE VEPRIMET

Rekomandimet e Studimit të Fizibilitetit përqendrohen në dorëzimin e objektivave të projektit në lidhje me diversitetin kulturor, burimet e përbashkëta të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, dhe potencialin për nismat e orientuara nga trashëgimia dhe turizmi trashëgimor në rajon - të gjitha të integruara me zhvillim lokal ekonomik me fokus në turizëm, përderisa merren parasysh në mënyrë praktike burimet në dispozicion, autoritetet dhe kufizimet legjislative e të tjera.

Plani i Veprimit i cili është në qendër të Planit të Trashëgimisë fokusohet në adresimin e pikave të dobëta të trashëgimisë në mënyrë të tillë që të njoh marrëdhëniet në mes të trashëgimisë, mirëqenies së komunitetit dhe ekonomisë lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mjedisit jetësor. Kjo përfshin potencialet për turizëm, dhe përfaqëson një vazhdimësi dhe diversifikim të veprimeve tashmë të përfunduara apo lehtësuara nga grupet punuese rajonale dhe komunale.

Këto veprime kanë përfshirë:

- Krijimin dhe trajnimin e grupeve punuese rajonale dhe komunale.
- Mbledhjen e përgjithshme të të dhënave dhe ushtrimin për validimin e tyre.
- Vlerësimin e të dhënave për trashëgiminë dhe validimin e projekteve në secilën komunë.
- Pilot projektet që përqendrohen në ngjarje/ tradita kulturore në secilën komunë.
- Nismat e orientuara nga trashëgimia dhe pilot projektet për demonstrimin e turizmit.
- Seri punëtorish mbi trashëgiminë.

Bazuar në vlerësimet strategjike tashmë të përvijuara, objektivat dhe veprimet e ndërlidhura që janë planifikuar për tri vitet në vijim janë këto:

Objektivi 1

Rritje e vetëdijes dhe promovim i vlerësimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

Veprimet dhe partnerët e mundshëm

1.1 Organizimi i mbledhjes në vijim të të dhënave dhe validimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit duke përfshirë praktikën dhe traditat lokale, lokalitetet, trashëgiminë e luajtshme dhe produktet kulturore.

(PTD, OShC-të, QRTK, akademia, komunat përkatëse)

1.2 Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për promovimin e trashëgimisë me përfshirjen aktive të komunitetit, duke theksuar praktikën lokale, lokalitetet dhe produktet kulturore në rajon.

(PTD, mediet, praktikuesit, OShC-të, QRTK, komuniteti i biznesit, komunat)

1.3 Të zhvillohet dhe miratohet një strategji e përbashkët rajonale arsimore dhe vetëdijesuese me të gjitha komunat e përfshira, duke përfshirë konkurse, ngjarje dhe punëtori

(PTD, OShC-të, komunat, AZhR-Jug, shkollat lokale, Drejtoritë Komunale për Arsim, praktikuesit, ekspertët e trashëgimisë)

1.4 Promovimi i Planit Rajonal të Trashëgimisë dhe rezultatet e zbatimit të tij përmes një numri të aktiviteteve vetëdijesuese duke punuar me partnerët lokal, rajonal dhe qendror sipas nevojës

(PTD, komunat, AZhR-Jug)

1.5 Të përmirësohet vetëdijesimi për qasjen e integruar ndaj trashëgimisë në mesin e autoriteteve dhe publikut të gjerë.

(PTD, QRTK)

1.6 Të mirëmbahet faqja e internetit që promovon rajonin dhe aktivitetet në zhvillim e sipër

(PTD)

Objektivi 2

Marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

Veprimet dhe Partnerët e mundshëm

2.1 Të sigurohen vlerësimi i vazhdueshëm i të dhënave për trashëgiminë

(PTD, OShC-të, QRTK, akademitë, komunat përkatëse)

2.2 Të inicohet përpilimi i një inventari mbi elementet e trashëgimisë kulturore jo materiale në bashkëpunim me institucionet shkencore dhe/ose ekspertët në bashkëpunim edhe me praktikuesit e tyre.

(PTD, OShC-të, komunat, pronarët, praktikuesit, Muzeu Etnologjik i Prizrenit)

2.3 Të inicohen projektet për konservimin e artefakteve arkeologjike dhe artefakteve të tjera të trashëgimisë pas konsultimeve me institucionet qendrore.

(MKRS, Instituti i Arkeologjisë, Komunat, QRTK)

2.4 Të inicohet vlerësimi rural me vëmendje të veçantë ndaj biodiversitetit dhe aseteve të trashëgimisë natyrore, duke përfshirë edhe identifikimin e specieve me interes më të lartë për ruajtjen e tyre në rajon.

(MMPH, komunat, OShC-të, AZhR-Jug)

2.5 Të ndërmiret një inventarizim i zonave të peizazheve nga perspektiva e trashëgimisë.

(PTD, MMPH, komunat, OShC-të)

2.6 Të krijohet një bazë e të dhënave për muzetë dhe koleksionet e tyre (trashëgimia kulturore e luajtshme)

(Muzeu i Kosovës, Instituti Etnologjik, Muzeu Arkeologjik dhe Etnologjik i Prizrenit, komunat, OShC-të)

2.7 Të hartohet një "Regjistër i Trashëgimisë në Rrezik".

(PTD, OShC-të, QRTK)

2.8 Të krijohet një hartë e aseteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore të ndërtuar, elementeve të trashëgimisë kulturore jo materiale, artikujve të trashëgimisë së luajtshme dhe lokaliteteve të trashëgimisë natyrore bazuar në studime dhe hulumtime gjithëpërfshirëse

(PTD, QRTK, OShC-të, komunat)

Objektivi 3

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësim i plotë, dizajn i integruar i projektit dhe planifikim i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

Veprimet dhe partnerët e mundshëm

3.1 Të nxitet koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të të gjitha agjencive të trashëgimisë dhe planifikimit hapësinor, autoriteteve të interesuara dhe individëve në rajon

(PTD, QRTK, OShC-të, komunat, MMPH)

3.2 Të shfrytëzohen mjetet për konservim dhe menaxhim të prezantuara në Procesin e Lubjanës të Projektit Rajonal të KiE/BE, projektit të PDKK-së i BE/KiE si dhe projektet dhe programet e tjera të implementuara me sukses me mbështetje nga organizatat përkatëse ndërkombëtare.

(PTD, QRTK, komunat, MMPH)

3.3 Të organizohen forume të rregullta rajonale për trashëgiminë për të përditësuar të gjitha palët e interesuara.

(PTD)

3.4 Të botohet një publikim vjetor "Trashëgimia Jonë e Përbashkët - Një Rishikim i Shoqërisë Civile në Kosovën jugore", përmes të cilit do të ndahen rezultatet e hulumtimeve dhe vlerësimeve.

(PTD, Forumi i Trashëgimisë)

3.5 Të ofrohet qasje e rregullt dhe e duhur në lokalitetet e përzgjedhura të trashëgimisë me perspektivë turizmi, duke përfshirë shenjëzimin dhe shërbimet udhëzuese.

(QRTK, Komunat, MKRS, Ministria e Transportit dhe Komunikimit)

Objektivi 4

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikat e duhura për menaxhimin e trashëgimisë në Kosovën Jugore.

Veprimet dhe Partnerët e mundshëm

4.1 Të koordinohen rishikimet vjetore të implementimit të Planit të Trashëgimisë dhe përgatitjet për planin e radhës të trashëgimisë në vitin 2018 për një periudhë tjetër trevjeçare.

(PTD, Forumi i Trashëgimisë)

4.2 Të sigurohen shërbime cilësore të përmirësuara për nismat e orientuara nga trashëgimia dhe/ose turizmi përmes zhvillimit profesional.

(GPNM, PTD, OShC-të, komunat)

4.3 Të zhvillohen mjete dhe mekanizma për një qasje të integruar për rehabilitimin e trashëgimisë, ndërmarrjeve/turizmit dhe programeve arsimore me partnerë të shumëfishtë.

(PTD, komunat, OShC-të, QRTK)

4.4 Të planifikohen programe të posaçme në bazë të rrjedhës së tanishme dhe asaj potenciale të turizmit.

(komunat, OShC-të, komuniteti i bizneseve)

4.5 Të inicohen plane për rehabilitimin e trashëgimisë së paluajtshme kulturore të përgjedhur, trashëgimisë jo materiale dhe trashëgimisë natyrore përmes dialogut aktiv ndërkulturor në mes të të gjithë palëve të interesuara (qendrore dhe lokale), duke përfshirë edhe komunitetet e marginalizuara.

(Projektet që janë duke operuar në rajon, QRTK, OJQ-të)

4.6. Koordinatorëve të PTD-së t'iu sigurohet mbështetje operationale, financiare dhe politike si dhe ndihmë teknike.

(komunat, QRTK)

Objektivi 5

Të zhvillohen nisma të përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

Veprimet dhe partnerët e mundshëm

5.1 Të inicohet një program trajnues për udhërrëfyesit lokal me kohë të pjesshme në secilën komunë.

GPNM, PTD

5.2 Pjesëmarrja në projektet e orientuara nga turizmi.

(PTD, komunat, OShC-të, komuniteti i bizneseve)

5.3 Të bëhet një analizë kosto/benifitit mbi projektet e propozuara në mënyrë që aplikimet të radhiten në mënyrë të koordinuar sipas prioritetit për financim.

(PTD, QRTK, komunat, kompanitë hulumtuese)

5.4 Të sigurohen veprime të koordinuara në mënyrë që të shfrytëzohen asetet e ndryshme të trashëgimisë dhe praktikatat e përhapura në mbarë rajonin.

(OShC-të, komunat, PTD, AZhR-Jug)

5.5 Të përmirësohen shërbimet bazike të turizmit bazuar në NVM (bizneset familjare)

(kompanitë huadhënëse, bankat, komunat, anëtarët e komunitetit)

5.6 Të mbështeten praktikatat e trashëgimisë kulturore jo materiale përmes aplikimit të përgjegjshëm të industrive kreative - si një lidhje me nismat/aktivitetet e arteve bashkëkohore në rajon.

(OShC-të, artistët, komunat, PTD, komuniteti i bizneseve)

5.7. Së bashku me komunat e tjera në rajon të zhvillohet një program i përbashkët rajonal që synon brendimin e rajonit me logon e tijrajonale.

Plani i Veprimit do të monitorohet nga koordinatori i Programit të Trashëgimisë dhe Diversitetit me mbështetjen e komunave pjesëmarrëse të rajonit.





Xhamia e Sinan Pashës, një detal nga interieri,
shek.17 - shek.19, Prizren



07

*Kisha e Levishës, shëk. 14, Prizren,
pamje nga jug-lindja*

KOMUNAT E RAJONIT JUGOR



Përderisa Programi Rajonal i PPZhL ka një fushë veprimi më të gjerë në sferën e zhvillimit ekonomik, PDKK/ZhEL përqendrohet në nismat e orientuara nga trashëgimia në raport me turizmin trashëgimor me parimet e pjesëmarrjes demokratike në procesin zhvillimor. Në këtë kapacitet, PDKK/ZhEL synon të krijojë kushtet për të lehtësuar kohezion dhe zhvillim ekonomik përmes shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për rajonin e Kosovës Jugore.

Qasja e sugjeruar e integruar vendos një strukturë, metodologji dhe shembuj të arsyeshëm se si, nëse menaxhohet me efikasitet, trashëgimia mund të bëhet një aset i dobisë së madhe për komunitetet lokale si pjesë e procesit zhvillimor dinamik social dhe ekonomik.

Në përgatitje të Planit Rajonal për Trashëgimi, projekti i PDKK-së njihet ekzistencën e të gjitha lokaliteteve dhe aseteve të trashëgimisë në rajon, duke u bazuar në informacionin e ofruar nga autoritetet dhe institucionet lokale dhe qendrore, si dhe nga komunitetet lokale dhe OShC-ve.


Sidoqoftë, pilot veprimet dhe veprimet e rekomanduara janë përqendruar në atraksionet dhe tiparet të cilat aktualisht janë të qasshme dhe mund t'i prezantohen publikut të gjerë dhe vizitorëve për qëllime të turizmit trashëgimor.

Ky kapitull është përgatitur për palët e interesuara në komunat përkatëse për të përcjellë Planin Rajonal të Trashëgimisë dhe rekomandimet e tij. Ai nxit përfshirjen aktive të komuniteteve lokale dhe palëve të interesuara në zbatimin e veprimeve me prioritet në komunën përkatëse, në bashkëpunim me pesë komunat e tjera në rajon, si dhe me autoritetet qendrore.

Sugjerimet e ofruara nuk janë përfundimtare dhe në asnjë mënyrë nuk sugjerojnë përjashtimin e nismave dhe burimeve të tjera të cilat janë detajuar në shtojca. Plani i Trashëgimisë, duke ofruar një rrugë të qëndrueshme për të ardhmen, inkurajon shfrytëzimin e këtyre aseteve të trashëgimisë në koordinim me të gjithë palët e interesuara, duke marrë parasysh konsiderimet strategjike theksuara në Pjesën 5.

Plani i Trashëgimisë është një proces dinamik që ofron një kontekst strategjik për veprimet e komunitetit me burimet ekzistuese për të siguruar përfitimet më të mëdha për komunitetet lokale në rajon. Ai synon që të lehtësojë veprimet e përbashkëta në identifikimin e prioritetëve për shpërndarjen e

fondeve në dispozicion për konservimin dhe promovimin e trashëgimisë, në bashkëpunim me qeverinë qendrore, komunat dhe palët e interesuara. Për të siguruar angazhimin aktiv të palëve të interesuara, projekti i PDKK-së miratoi metodologjinë dhe rrjedhën e punës në vijim, duke siguruar një raportim të vazhdueshëm dhe prurje nga komunitetet në politikëbërje, përderisa njohuria bazë dhe transferimi i aftësive nxitet në nivel të komunitetit.



Përfshirja në projektin e PDKK-së përfshinte:

- Hulumtimin mbi asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe identifikimin e elementeve të trashëgimisë jo materiale me pjesëmarrjen dhe kontributin e:
 - MKRS - Departamentit për Trashëgimi Kulturore
 - Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren
 - Komunat e Rajonit Jugor
 - OJQ Ec Ma Ndryshe
 - OJQ Omladina Gora
 - OJQ Katedra Slobodnog Uma
 - OJQ Durmish Asllano
 - OJQ CHWB
 - Vullnetarët e Komunitetit
 - Ekspertët lokal mbi Trashëgiminë Natyrore
 - Ekspertin lokal mbi zhvillimin e aplikacionit për bazën e të dhënave
- Veprimet pilot me pjesëmarrje aktive të komuniteteve në rajon në prezantimin dhe promovimin e elementeve dhe praktikave të tyre të përbashkëta jo materiale.
- Një seri punëtorish mbi trashëgiminë në procesimin e planit dhe krijimin e një platforme për bashkëpunim në kuadër të rajonit si dhe mes rajoneve.
- Një Forum i Trashëgimisë me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve, për të kontribuar në zhvillimin e Planit Rajonal të Trashëgimisë.
- Inventarizimi i aseteve të luajtshme të trashëgimisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren.
- Zhvillimi i logove rajonale.
- Vizitat studimore dhe sesionet trajnuese për të ju mundësuar palëve lokale të shohin

- praktikat e mira në mënyrë që ata të pajisen me njohuri dhe të kuptuarit bazëmbi proceset e zhvillimit lokal ekonomik, përfshirjen e komunitetit dhe pjesëmarrjen demokratike.
- Mbledhjet e Rrjetit të Komunitetit të Trashëgimisë me përfshirjen e një game të gjerë të individëve dhe entiteteve të cilët çojnë aspektet specifike të trashëgimisë.
 - Aktivitetet për rritjen e vetëdijes përmes vizitave në lokalitetet dhe sesionet trajnuese mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore me pjesëmarrjen e:
 - Mësimdhënësve të shkollave fillore
 - Nxënësve
 - Prindërve
 - Artizanëve
 - Të moshuarve
 - Komuniteteve lokale
 - OJQ-ve lokale

Veprimet e menjëhershme që u rekomandohen komunave në rajon

- Në forumin e parë që pason pas lansimit të Planit të Trashëgimisë, dhe së bashku me koordinatorët e PTD-së, të identifikohen fushat në komunë në të cilat një aset potencialisht mund të identifikohen si një zonë e caktuar.
- Të krijohet një grup i veprimit i komunitetit për këtë çështje.
- Të diskutohen mundësitë me autoritetet komunale.
- Me miratimin e autoriteteve komunale, të ndërmerret një proces i konsultimit me komunitet duke përfshirë anëtarët e komunitetit nga zonat e caktuara.
- Të shpjegohet Plani i Trashëgimisë dhe rëndësia e veprimit të përbashkët rajonal në kontekstin të çdo rajoni përkatës të Kosovës dhe të tërë Kosovës.
- Së bashku me komunitetet, të zhvillohet një vizion i përbashkët dhe një veprim i integruar në linjë me rekomandimet e Planit të Trashëgimisë Jug.
- Të zhvillohet një dokument ideor për t'u miratuar dhe mbështetur nga autoritetet komunale.
- Të punohet bashkërisht me koordinatoren e PTD-së i cili do të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të komunave dhe qasje rajonale.
- Të kërkohet mbështetja nga organizatat e tjera të cilat veprojnë në rajon për zbatim në të ardhmen.

Komuna a Dragashit

Komuna e Dragashit shtrihet ne rajonin jugor, 22 kilometra në juglindje të Prizrenit. Komuna përbëhet nga 37 fshatra dhe shtrihet në rajonet e Opojës dhe Gorës, me një popullsi prej rreth 33,997 banorëve që përbëhen nga shqiptarët (59,67%), goranë (26,34%), boshnjakë (12%) dhe të tjerë (2,06%).

Dragashi është një nga zonat më të largëta në Kosovë, e cila ruan traditat e vjetra dhe mënyrën e të jetuarit të gdhendur nga natyra përreth. Ajo kufizohet nga Parku Kombëtar i Sharrit, Mali i Koritnikut, dhe malet e Gjallicës dhe Cylenit në drejtim të Prizrenit.

Trashëgimia materiale

- Kështjella e Hisarit, fshati Krushevë (Neoliti/Antikiteti i Vonë/ Mesjetë)
- Kështjella e Brrutit (Neoliti/Antikiteti i Vonë/ Mesjetë)
- Rrënojat e monumentit fetar (Namazxhah) në fshatin Buzez (shek. 16)
- Xhamia e Kukli Beut në Bresanë (shek. 16)
- Tyrbja e Selim Dedës (mauzoleu) në Restelicë (shek. 18)
- Xhamia e fshatit (Berat), në fshatin Zlipotok (shek. 16/ shek. 20)
- Tyrbja në fshatin Dragash (shek. 17)
- Varri i madh (Sallatash në fshatin Kapre (shek 18)
- Mulliri i vjetër në fshatin Dragash (shek. 19)
- Mulliri i vjetër dhe valavica (mjeti i mullirit për procesimin e leshit për të bërë veshje tradicionale për meshkuj) në fshatin Bellobrad (shek. 19)

*Valavicë mulliri në fshatin Bellobrad,
komuna e Dragashit*

Trashëgimia Natyrore

- Mali i Koritnikut
- Liqeni i Breznës (Opojës)
- Gryka e Rastelicës
- Lumi Radeshë
- Parku Kombëtar i Malit Sharr

Trashëgimia jo materiale

- Lojërat e fshatrave (Pelivanët)
- Baladat e Gorës
- Çadra tradicionale martesore
- Ritualet e ngjyrosjes së fytyrës

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar ne Planin dhe Programimin Rajonal

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollorë për ngritje të vetëdijes në komuna.
- Të shfrytëzohet logoja rajonale për brendim.
- Të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Dragash, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzuesve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shenjzimi i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.
- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës në rajon.
- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërf-

shirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikat e duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësive për menaxhim të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.


- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunë për të marrë pjesë në planin rajonal
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikat e trashëgimisë kulturore lokale, siç është bërja e çadrave tradicionale martesore dhe pikturimit të fytyrës.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B)
- Të bëhet Dragashi një destinacion turistik për strukturat e veçanta tradicionale të agrikulturës përcjellë nga aktivitete gastronomike dhe tradicionale.

Zhvillimi i Agrikulturës dhe Peizazhit të Zonës - Mullinjtë e vjetër dhe Peizazhi i fshatrave Bellobrad, Bresanë, Krushevë, Kuk, Radeshë, Milkë.

Si struktura tradicionale të agrikulturës, mullinjtë që ekzistojnë ende në fshatrat e Komunës së Dragashit, mund të bëhen një destinacion atraktiv turistik që përfaqëson teknika specifike të ndërtimit, kontekstin fizik të lokacionit të tyre si dhe stilin tradicional të jetës së popullsisë lokale.

Veprimet: Vlerësimi gjithëpërfshirës i gjendjes aktuale të strukturave prej gurit të mullinjve dhe mekanizmat e tyre prej druri në mjedisin përreth; Strategjia për rehabilitimin e zonave në fjalë për qëllime turistike; Aplikimet për projekte (sigurim fondesh) për restaurimin e strukturave të mullinjve dhe mjedisit/peizazhit sipas kriterëve dhe standardeve të zhvilluara.

Partnerët: sektorët komunal për planifikim, kulturë dhe turizëm, komunitetet lokale, palët e interesuara/pronarët, MKRS (QRTK - Prizren), MMPH - mbrojtja e natyrës dhe mjedisit, OJQ-të lokale.





Lumbardhi, Prizren

Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës shtrihet në rajonin jugor të Kosovës, 44 km larg qytetit të Prizrenit. Ajo i ka 43 fshatra me një popullsi të përgjithshme prej rreth 54,613 banorëve, që përbëhet nga shqiptarët (99.9%) dhe romët (0,01%). Malisheva kufizohet më komunën e Klinës dhe Glllogocit në veri dhe komunën e Lipjanit dhe Suharekës në jug. Territori i saj është kryesisht malor dhe karakterizohet nga mali i Drenicës, ku pikat e tij më të larta janë Kozniku dhe Kosmaçi. Lumi Mirushë rrjedh përmes qytezës së Malishevës duke krijuar ujëvara të veçanta dhe të bukura. Agrikultura është një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe gjenerues i të ardhurave për banorët e komunës.





*Ura e Vjetër afër fshatit Bubel,
komuna e Malishevës*

Trashëgimia materiale

- Lokaliteti arkeologjik Trojet e Vjetra
- Ura e Arabaxhive në fshatin Buble,

Trashëgimia Natyrore

- Burimet termale të Banjës
- Shpella e Panorcit
- Ujëvarat e Mirushës

Trashëgimia jo materiale

- Këngët epike (rapsoditë)

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar ne Planin dhe Programimin Rajonal

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes në komuna.
- të shfrytëzohet logo rajonale për brendim.
- të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Malishevë, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzuesve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shënjestrimi i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.
- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës

në rajon.

- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërfshirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikatat e duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësive për menaxhim të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunën e Malishevës për të marrë pjesë në planin rajonal
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikatat e trashëgimisë kulturore lokale, siç janë këngët tradicionale epike.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B).
- Të përgatitet Malisheva për të zënë vendin e saj në rajonin e jugut si një destinacion turistik me burimet e saj të ujërave minerale, shpellat dhe lokalitetet arkeologjike së bashku me aktivitetet tradicionale.

Përfshirja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore e komunës në një hartë turistike të rajonit

Burimet termale të Banjës tashmë janë promovuar si potencial për zhvillimin ekonomik dhe turistik të komunës. Një program për ecjet në këmbë deri tek lokaliteti arkeologjik i Trojeve të Vjetra, ura e vjetër e Arabaxhive në fshatin Buble dhe Shpellën e Panorcit, promovon një gamë më të gjerë të atraksioneve për vizitorët e burimeve termale.

Veprim: Të zhvillohet një projekt hulumtimi për mundësitë e integritit të atraksioneve në një ofertë turistike për rangjet e ndryshme të vizitorëve.

Partnerët: autoritetet komunale, sektori i biznesit lokal, Instituti për Arkeologji.

Komuna e Mamushës

Mamusha është qyteza më e vogël e cila shtrihet në pjesën veriore të Prizrenit, me një sipërfaqe prej vetëm 11 km² dhe një popullsi prej rreth 5,507 banorësh. Ajo kufizohet me komunat e Gjakovës dhe Suharekës. Popullsia përbëhet nga turqit (93.1%), Shqiptarët (5,9%) dhe të tjerët (0,9%).

Komuna e Mamushës ka terren kryesisht të rrafshët me karakter rural dhe është ideale për zhvillimin e agrikulturës.

Trashëgimia materiale

- Sahat Kulla e Mahmut Pashës në Mamushë

Trashëgimia Natyrore

- Lumi Toplluha
- Lumi Tërnja

Trashëgimia jo materiale

- Festivali i domateve

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar ne Planin dhe Programimin Rajonal

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes në komuna.
- Të shfrytëzohet logo rajonale për brendim.
- Të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Mamushë, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzuesve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.



*Sahat Kulla e Mahmut Pashës,
komuna e Mamushës*

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shenjëzimi i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.
- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës në rajon.
- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërfshirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikrat e duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësive për menaxhim të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunën e Mamushës për të marrë pjesë në planin rajonal
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikrat e trashëgimisë kulturore lokale, siç janë këngët tradicionale epike.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B).
- Të përgatitet Mamusha për të zënë vendin e saj në rajonin e jugut si një destinacion turistik me burimet e saj të ujërave minerale, shpellat dhe lokalitetet arkeologjike së bashku me aktivitetet tradicionale.

Të zhvillohet një “treg i lëvizshëm” në zonën e Sahat Kullës së vjetër

Programi njëditor i “Festivalit të Domateve” i cili organizohet çdo vit gjatë verës në qendër të Mamushës mund të pasurohet me një ofertë specifike të tregut për produktet bujqësore të brenduara, që janë specifike për zonën dhe të prezantuara në stenda mobile të dizajnuara mirë. Produktet që kanë afat të gjatë të skadimit do të mund të ekspozohen për shitje në brendi të Sahat Kullës së Mahmut Pashës - monumenti kulturor më përfaqësues i qytetit.

Veprim: Duke marrë parasysh gjendjen e keqe të monumentit do të ishte një mundësi e mirë për të zhvilluar një projekt kompleks që integron mbrojtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin ekonomik përmes aktiviteteve të ndërlidhura me konservimin dhe restaurimin e Sahat Kullës dhe rehabilitimin e zonës përreth ndërtesës, me synim që ajo të shfrytëzohet si treg i lëvizshëm për produktet lokale të brenduara.

Partnerët: Komuna, MKRS/QRTK-Prizren, sektori i biznesit dhe turizmit

Komuna e Prizrenit

Prizreni është një qytet i lashtë i cili shtrihet në rrëzë të maleve të Sharrit dhe përgjatë lumit Lumbardh. Ai është qendra administrative e komunës dhe qendra kryesore ekonomike dhe turizmit trashëgimor e pjesës jugperëndimore të Kosovës.

Komuna e Prizrenit i ka 76 vendbanime me një popullsi prej rreth 178,000 banorësh gjë që e bën qytetin e dytë më të madh në Kosovë. Banorët e Prizrenit janë kryesisht shqiptarë (81.97%), boshnjakë (9.5%), serb (0.13%), turq (5.1%), rom (1.63%) dhe të tjerë (1.65%). Në komunën e Prizrenit, gjuhët zyrtare janë shqipja, serbishtja, boshnjakishtja dhe turqishtja.

Komuna e Prizrenit kufizohet me komunat e Dragashit, Rahovecit, Gjakovës dhe Shtërpcës, si dhe kufirin kombëtar me Shqipërinë dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Trashëgimia materiale

- Lokaliteti arkeologjik i Vlashnjes (Neoliti/ Antikiteti i Vonë/ Mesjeta e Hershme)
- Lokaliteti arkeologjik në Korishë (Epoka e Bronzit/ Mesjetë e Hershme)
- Lokaliteti arkeologjik në Poslishtë (Romak)
- Kalaja e Prizrenit (Antikiteti i Vonë/ Osmane)
- Kisha e Levishës - Kisha e Shën Premtës (shek. 14)
- Kisha e Shën Nikollës (Tutiqve) (shek. 14)
- Manastiri i Kryenegjëjve të Shenjtë (shek. 14)
- Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë (shek. 14)
- Kisha e Shën Gjergjit (Runoviq) (shek. 14)
- Kërëk xhamia - Namazxhah (1455)
- Xhamia e Suzi Çelebisë (1513)
- Xhamia e Kukli Mehmet Beut (1535/1897)
- Xhamia e Gazi Mehmet Pashës (1563-1575)
- Hamami i Gazi Mehmet Pashës (shek. 16/ 1833)
- Muzeu Arkeologjik i Prizrenit - Hamami (fundi i shek. 15)
- Xhamia e Sinan Pashës (1615)
- Shadërvani (shek. 17)
- Teqja Halvetie (shek. 17 /1835)
- Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit/ Muzeu Historik (rindërtuar në shek. 20)
- Kisha e Shën Gjergjit/ Sinodale (1856-1887)
- Beledije/Selia e Komunës së Prizrenit (fundi i shek. 19)
- Shtëpia e Familjes Shehu (shek. 19)
- Shtëpia e Musa-Efendi Shehzade/ Muzeu Etnografik (shek. 19)
- Hidrostacioni Prizrenasja (fillimi i shek. 20)

Trashëgimia Natyrore

- Parku Kombëtar i Malit Sharr
- Lumi i Lumbardhit
- Rrapi i Marashit





Hidrostationi afër Prizrenit, gjysma e parë e shek.20, fasada balllore

Trashëgimia jo materiale

- Filigrani
- Tradita e farkatarëve
- Festivali i Zambakut
- Festivali Tradicional Hasi Jehon
- Aktiviteti artistik kulturor Sculpfest
- Kostumet tradicionale të rajonit të Hasit
- Ngjyrosja e fyturës në fshatin Lubinjë e Ulët

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar në Planin dhe Programimin Rajonal

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes në komuna.
- Të shfrytëzohet logo rajonale për brendim.
- Të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikrat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Prizren, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzuesve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shënimi i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.
- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës në rajon.
- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërfshirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikrat e duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësive të shtuara të menaxhimit të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.

- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunën e Prizrenit për të marrë pjesë në planin rajonal
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikat e trashëgimisë kulturore lokale, siç janë ngjyrosja tradicionale e fytyrës, filigrani, Sculpfesti, Dokufesti.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B).
- Të zhvillohet Prizreni si destinacion turistik në bashkëpunim me komunat e tjera të rajonit, për të tërhequr interesa të ndryshme për oferta rajonale.

Qendra arsimore dhe afariste e Prizrenit - kompleksi i "Tabakhanes"

Njëherë e një kohë ky kompleks konsiderohej si vendi i zejes së përpunimit tradicional të lëkurës (tabak). Sidoqoftë, shumica e tipareve të saj të vlefshme për momentin nuk janë të dukshme. Sektorët që mbesin - mulliri dhe objektet për magazinimin e lëkurës - mund të restaurohen dhe përshtaten si punëtori për praktikuesit e filigranit, duke i bashkuar ata në një kooperativë si dhe për të mbështetur programet arsimore në zhvillim e sipër të kësaj zeje tradicionale. Së bashku me pjesën tjetër të trashëgimisë së ndërtuar në afërsi - ndërtesa Beledije dhe shkolla e mesme Ruzhalie (për momentin në rrënoja) - një kompleks i ri që ofron një qendër atraktive e cila përfaqëson trashëgiminë industriale, arkitekturale dhe jo materiale të Prizrenit që do të mund t'i prezantohet publikut të gjerë.

Veprim: Projekti për rekonstruktimin e strukturave të dëmtuara me vizion që të zhvillohet një qendër arsimore dhe komerciale e bazuar rreth zejeve tradicionale.

Partnerët: Bashkëpunimi në mes të MKRS/QRTK-Prizren dhe Komuna e Prizrenit.



Ndërtesa e Beledijes, Prizren

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit i ka 35 fshatra me një popullsi prej rreth 56,208 banorë, e cila përbëhet nga shqiptarët (97.8%), serbët (1.66%) dhe të tjerët (0.54%). Komuna e Rahovecit kufizohet me komunat e Klinës, Suharekës, Prizrenit dhe Gjakovës.

Komuna është e njohur për trashëgiminë e saj fetare dhe i ka 23 xhami dhe 12 kisha dhe manastire në përdorim të cilat janë kryesisht të përqendruara në fshatin e Hoçës së Madhe. Gjithashtu njihet edhe si qyteti i vreshtave dhe verën e shijshme të cilësisë së mirë.

Trashëgimia materiale

- Lokaliteti arkeologjik në Pozhigë, fshati Bellacerkë (romak)
- Banja termale në fshatin Çiflak (romak)
- Rrënojat e vendbanimit të fortifikuar në fshatin Zatriç (Epoka e hekurit/Antikiteti i Vonë)
- Kështjella e urës së gurit, Rahovec (romak)
- Kështjella në fshatin Gexhë (Antikiteti i Vonë)
- Varrezat në fshatin Celinë (Mesjetare)
- Varrezat në fshatin Vranjak (Mesjetare)
- Kisha e Bërnyaçës (shek. 14)
- Kisha e Shën Nikollës në Hoçë të Madhe (shek. 14-16)
- Kisha e Shën Gjergjit në Hoçë të Madhe (shek. 13 dhe 14)
- Teqja Halvetie, qendra e Rahovecit (shek. 18)
- Fontana e vjetër, Rahovec (shek. 18 dhe 19)
- Teqja e Melamive (masxhid), Rahovec (1887, rindërtuar 1970)
- Xhamia e fshatit në Zatriq (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Pastasellë (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Drenoc (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Xërxe (shek. 18)
- Shtëpia e Qamil Vuçitërnës, Rahovec (shek. 19)
- Kulla e Hajrullah Çantës, Rahovec (shek. 19)
- Konaku i Manastirit të Deçanit, në Hoçën e Madhe (shek. 19)
- Shtëpia e familjes Spasiq në Hoçë të Madhe (shek. 19)
- Kulla e Ismet Çmegës (shek. 19)
- Xhamia e Kosumit, Rahovec (1826)
- Xhamia e Sokolit, Rahovec (1824)
- Manastiri i Zoçishtës, fshati Zoçishtë (Mesjetare/ shek. 19)

Trashëgimia Natyrore

- Ujëvarat e Mirushës

Trashëgimia jo materiale

- Festival i verës

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar ne Planin dhe Programimin Rajonal

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes në komuna.
- Të shfrytëzohet logo rajonale për brendim.
- Të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikrat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Rahovec, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzimeve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shenjzimi i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.



Fragment nga një shtyllë e lokalitetit arkeologjik të Çifllakut, periudha romake, komuna e Rahovecit (foto: MKRS)



Stoli nga nekropolisi i Shirokës, Epoka e vonë e hekurit (foto:MKRS)

- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës në rajon.
- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërfshirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikat e duhura të menaxhimit për kujdesin e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësivete shtuara të menaxhimit të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunën e Rahovecit për të marrë pjesë në planin rajonal
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikat e trashëgimisë kulturore lokale, siç është festivali tradicional i verës.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B).
- Të zhvillohet Rahoveci si një destinacion turistik që kombinon verën, turizmin fetar dhe natyrën.



Turizmi rural dhe udhëtimet fetare në Hoçë të Madhe dhe Rahovec

Ansamblet e arkitekturës popullore të Hoçës së Madhe, kishat e shumta mesjetare të cilat janë ende të ruajtura mirë dhe në përdorim të rregullt, si dhe përpjekjet fillestare të suksesshme që janë bërë për të themeluar qëndrim me Fjetje dhe Mëngjes për vizitorët në shtëpitë tradicionale, i japin zonës potencial të madh për zhvillimin e një oferte të veçantë turistike.

Peizazhi i mahnitshëm i vreshtave në zonë, puna krijuese e murgjve të Deçanit në prodhimin e verës së cilësisë së mirë, dhe mbështetjen e Komunës së Rahovecit për organizimin e Festivalit të Verës, e bëjnë këtë zonë një prej destinacioneve më tërheqëse për një sërë vizitorësh.

Veprim: Program dhe plan për të mbështetur nismat e orientuara drejt komunitetit, posaçërisht në revitalizimin e objekteve tradicionale të banimit të përzgjedhura për t'u shfrytëzuar për qëndrimin me Fjetje dhe Mëngjes.

Partnerët: Komuna e Rahovecit, pronarët e objekteve tradicionale të banimit në Hoçë të Madhe dhe Rahovec, sektori i biznesit dhe turizmit, MKRS/QRTK-Prizren.



Sahat Kulla në Rahovec

Komuna e Suharekës

Suhareka është një qytet dhe komunë në rajonin jugor e cila shtrihet vetëm 18 km larg qytetit të Prizrenit. Komuna e Rahovecit e ka një popullsi prej rreth 72,000 banorë, e cila përbëhet nga shqiptarët (99.3%), serbët (0.01%), romët (0.57%) dhe të tjerët (0.12%).

Emri Suharekë do të thotë "Lumi i Thatë" në serbisht. Më vonë qyteti quhet Therandë, emri i kështjellës antike të Therandës, në afërsi të Prizrenit.

Trashëgimia materiale

- Lokaliteti arkeologjik në Hisar, Suharekë
- Lokaliteti arkeologjik i Reshtanit (Epoka e neolitit)
- Varret (Tumulet ilire) e Gjinocit (Fundi i Epokës së Hekurit)
- Varret (Tumulet ilire) afër fshatit të Shirokës (Fundi i Epokës së hekurit/ shek. 6-8 p.e.s.)
- Lokaliteti arkeologjik - vendbanimi i fortifikuar i Kastercit (Epoka e bakrit/ Mesjetë)
- Mulliri i vjetër i familjes Buzhala, Suharekë

Trashëgimia natyrore

- Guri i Dellocit
- Burimi i ujit mineral në Reqan
- Rezervati natyror i Rushenicës
- Parku natyror Rahavan
- Lisi në Bllacë
- Parku Kombëtar i Malit Sharr

Trashëgimia jo materiale

- Muzika tradicionale me gajde dhe fyell

Për të rritur vetëdijen dhe promovuar vlerësimin për trashëgiminë në Kosovën Jugore

- Të organizohen shëtitjet e lagjes/trashëgimisë për të rritur vetëdijen në mesin e popullsisë lokale, familjarizimi i banorëve me koncepte të ndryshme për trashëgiminë duke përfshirë vetë jetën e komunitetit.
- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes në komuna.
- Të shfrytëzohet logo rajonale për brendim.
- Të sigurohet grumbullimi i rregullt i mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e një ambienti të pastër.



Pejzash nga Malet e Sharrit

Veprimet me prioritet që rekomandohen për të kontribuar në Planin dhe Programimin Rajonal

Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikrat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Suharekë, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzuesve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t'i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.

Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të mbahet një hartë e qartë dhe e përditësuar për turizmin e trashëgimisë për të gjitha asetet që janë të gatshme për vizitorë.
- Faqja rajonale e internetit të përditësohet rregullisht në mënyrë që të tjerët të informohen për aktivitetet e ardhshme.
- Të sigurohen prurje për raportin vjetor rajonal mbi "Trashëgiminë Tonë të Përbashkët" në Kosovën Jugore.
- Të sigurohet shenjëzim i duhur për lokalitetet të cilat janë të gatshme për turizëm.
- Të testohen produktet kulturore dhe stilet e marketingut në fushën përkatëse të punës në rajon.
- Të sigurohet se nismat e orientuara nga trashëgimia janë të shumëllojshme, gjithëpërfshirëse dhe të dallueshme për të tërhequr anëtarët e komunitetit dhe vizitorët.

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikrat e duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Jugore

- Të organizohet zhvillimi i kapaciteteve për rritjen e aftësive për menaxhim të trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të këmbyer zhvillimet dhe për t'u informuar për programin rajonal.
- T'i dërgohen koordinatorit të PTD-së broshurat dhe materialet promovuese të punuara lokalisht.

Të zhvillohen nismat e përshtatshme në nivel lokal dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Jugore.

- Të identifikohet një shembull i trashëgimisë së ndërtuar në komunën e Suharekës për të marrë pjesë në planin rajonal.
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikrat e trashëgimisë kulturore lokale, siç është muzika tradicionale me gajde dhe fyell.
- Të mbështeten nismat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke përfshirë Fjetjen me Mëngjes (B&B).
- Të zhvillohet Suhareka si destinacion turistik duke kombinuar arkeologjinë, arsimin dhe muzikën.



Vazo nga lokaliteti arkeologjik në Reshtan



Stoli nga nekropolisi në Shirokë, Epoka e vonë e hekurit (foto: MKRS)

Kampi Hulmtues Arkeologjik i Kulturës Antike

Disa lokalitete të cilat janë njohur si vende të rëndësishme, dhe që përfaqësojnë kulturat e popullsisë lokale nga periudha e Neolitit deri në Mesjetë, mund ta bëjnë këtë zonë një fushë ngazëlluese të punës për hulumtuesit e rinj si dhe për entuziastët e arkeologjisë dhe historisë.

Veprim: Një program hulumtimi i dizajnuar mirë, i shoqëruar me ligjërata/rrëfime dhe aktivitete të tjera atraktive të kampit në hapësira të hapura në natyrë, mund të rekomandohen.

Partnerët: Komuna, Instituti për Arkeologji, QRTK-Prizren, OJQ-të lokale

08

Mulliri i Vjetër në Dragash

ZBATIMI I PLANIT TË TRASHËGIMISË - PËRPARIMI



Zbatimi i vazhdueshëm i Planit Rajonal të Trashëgimisë është një pjesë thelbësore e procesit dhe përfshirja aktive e palëve të interesuara lokale do të luajnë një rol thelbësor për efikasitetin e tij.


Duke qenë se procesi i Planit të Trashëgimisë është testuar dhe provuar se funksionon mirë në Kosovën Perëndimore, lidhja në mes të rajoneve, duke shikuar praktikën më të mira të Kosovës Perëndimore në veçanti, është thelbësore për zbatim. Për më tepër, shpresohet se marrëdhëniet profesionale të vendosura me Këshillin për Trashëgimi të Irlandës, Parkun Rajonal Natyror të Vosges në Francën Verior dhe Fondacionin Ballkanik për Trashëgimi në Bullgari mund të ndihmojnë shkëmbimet profesionale gjatë fazës së zbatimit gjatë periudhës së ardhshme. Krahas kësaj, shtetet pjesëmarrëse në programin rajonal të PPZHL të Këshillit të Evropës, mbesin pjesë e rrjetit që lejon shkëmbimet në mes të projekteve në vazhdim.

Për të koordinuar procesin, janë rekrutuar koordinatorë për Programin e Trashëgimisë dhe Diversitetit (PTD) për secilin rajon. Ata do të lehtësojnë, koordinojnë dhe monitorojnë zbatimin e Planit të Trashëgimisë, i cili ofron nismat e mundshme rajonale me kontributin e komunave përkatëse. Kështu, koordinatori i PTD-së, me mbështetjen e komunave, institucioneve dhe komuniteteve, punon për dobinë e të gjithë rajonit. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi konsistent i njohurive dhe aftësive në këtë fushë janë jetike për procesin e zbatimit. Koordinator i PTD-së siguron vlerësimin e nevojave për zhvillim të kapaciteteve dhe adreson këto nevoja duke nxitur lidhjet dhe dialogun e vazhdueshëm në mes të entiteteve dhe komuniteteve. Përderisa Plani për Trashëgiminë dhe veprimet e tij të rekomanduara e kanë rolin e një mjeti udhëzues, promovimi dhe përkrahja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në zhvillimin e nismave të orientuara nga trashëgimia mund të ndryshojnë bazuar në mjetet dhe gatishmërinë e komunave pjesëmarrëse. Ky plan fillestar luan një rol thelbësor në bashkimin e komunave dhe komuniteteve të rajonit për një vizion të përbashkët, duke u bërë gradualisht një pjesë efektive e strukturave lokale.

Zbatimi i vazhdueshëm i Planit Rajonal për Trashëgimi është një pjesë thelbësore e procesit dhe përfshirja aktive e palëve të interesuara lokale do të luajnë një rol thelbësor për efikasitetin e tij.

Nga kjo pikë e tutje, Plani për Trashëgiminë nxit një proces dinamik ku të gjitha palët e interesuara punojnë në shpirtin e solidaritetit dhe sinergjisë për të kontribuar në objektivat e tyre rajonale në komunat e tyre përkatëse dhe për më shumë angazhimit të tyre me komunat e tjera për të përfituar nga ky proces në mënyrën më pozitive. Dimensionet e këtyre përfitimeve shkojnë përtej mjeteve financiare dhe përfshijnë monitorimin e pjesëmarrjes demokratike të të gjitha komuniteteve në procesin e zhvillimit dhe rritjes relative në cilësinë e jetës dhe mjedisit jetësor.

PROGRAMIT I TRASHËGIMISË DHE DIVERSITETIT (PTD) DHE LIDHJA E TIJ ME RrKT DHE GPNM



Grafiku më sipër shfaq në vija të trasha qështjet kryesore. Idealisht, është paraparë që secili koordinator i PTD-së do të financohet nga komunat e përfshira në rajonet e tyre përkatëse (pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit, siç është finalizuar në Kosovën Perëndimore). Ata duhet të kryejnë punën e tyre në përputhje me pesë temat vijuese:

- Hulimtim
- Promovim
- Veprime inovative
- Zhvillim Profesional
- Përkrahje për krijimin e strategjive dhe planeve të trashëgimisë

Disa prej hapave të sugjeruar janë këta:


1. Programi i Trashëgimisë dhe Diversitetit dhe koordinatorët do të jenë të veçantë për secilin rajon dhe do të udhëhiqen nga një doracak i përbashkët.
2. Mostra të programeve të përbashkëta rajonale siç janë Itineraret Kulturore (tashmë duke u zbatuar nga PDKK-ja në perëndim, së bashku me nismat e tjera) do të inicohen nga PTD-të në rajonet e tjera.
3. Mbledhja vjetore e PTD-ve së bashku me RrKT dhe GPNM.
4. Raporti Vjetor - Trashëgimia Jonë e Përbashkët: ky rishikim i shoqërisë civile do të prodhohet çdo vit si një rezultat kyç i procesit të planit për trashëgiminë, për të promovuar dhe monitoruar përparimin e saj.
5. Rishikimi Periodik i Planeve Rajonale për Trashëgimi (i cili do të rishikohet dhe përditësohet çdo 3 vjet)
6. Një Plan për Trashëgimi i Kosovës do të përgatitet me kohë nga palët e interesuara lokale me RrKT dhe GPNM, nën udhëheqjen e koordinatorëve të PTD-së.
7. Raporti i Kosovës për Trashëgimi do të përgatitet nga palët e interesuara lokale me RrKT dhe GPNM, nën udhëheqjen e koordinatorëve të PTD-së.

Kjo është një plan i skenarit. Procesi i planit për trashëgiminë është vetërigjenerues por gjithashtu është edhe një proces dinamik i cili do t'i përgjigjet nivelit të interesimit, angazhimit dhe përkushtimit të komunitetit. Pronësia e procesit, gjatë vitit të ardhshëm, do t'i kalojë palëve lokale të interesuara dhe ata do të përmirësojnë dhe përshtatin skenarët e ardhshëm me kalimin e kohës.

Strategjia afatgjate

Me prezantimin e Planeve për Trashëgiminë në katër rajonet e tjera në Kosovë, sot të pesë rajonet - perëndim, jug, lindje, veri dhe qendër - kanë plane rajonale. Përmes metodologjisë, mjeteve dhe programeve mostër, të zhvilluara nga projekti i PDKK-së si dhe përmes vendosjes së koordinatoreve të Programit të Trashëgimisë dhe Diversitetit, është prezantuar një model afatgjatë operacional.

Përderisa Plani për Trashëgiminë ka të bëjë me tërë rajonin e Kosovës Jugore, lidhja në mes të nivelit komunal, rajonal dhe qendror është i domosdoshëm për një periudhë efektive dhe efikase të implementimit. Në këtë cilësi, bashkëpunimi dhe koordinimi i afërt në mes të Grupit Punues Ndërministror^{2*}, Rrjeti i Komunitetit të Trashëgimisë dhe koordinatorët e PTD-së në pesë rajonet do të sigurojnë integritetin e procesit dhe do të kontribuojnë zhvillimit të Planit të Trashëgimisë të Kosovës.



² Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Divizioni i Turizmit), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Referencat dhe Burimet e Përzgjedhura

V.Aliu – F. Drançolli – Nj. Haliti & A. Zeneli “Trashëgimia e evidentuar e Kosovës/Evidentiranih spomenici na Kosovu/Evidences Monuments of Kosova”, Ministry of Culture, Youth and Sports, Prishtinë/Priština 2005

Archaeological Guide of Kosovo, Pristina 2012 (publikim i MKRS)

Architectural and Urban Heritage (Trashëgimia Arkitekturore dhe Urbane)– Prizren - Kosovo, 2001

Database of the MCYS, 2014 (http://dtk.rks-gov.net/tkk_hyrje_en.aspx),

Draft analysis conducted by Cultural Heritage without Borders in the framework of Local Cultural Heritage Plans Program, Kosovo 2014.

Dr.F.Drançolli, Trashëgimia monumentale në Kosovë, Prishtinë 2011

EU CARDS programme for Kosovo (2009). “Sustainable Forest Management for Kosovo-Technical Report: Preliminary Identification of Natura 2000 sites in Kosovo. Prishtinë/Priština

Qeveria e Irlandës, “National Heritage Plan”, 2002

GTZ në emër të Departamentit për Turizëm, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
“Tourism Strategy Kosovo 2010-2020”, Ministry of Trade & Industry, Prishtinë/Priština 2010

Heritage Council in association with South Dublin County Council, “Heritage Plan 2010 – 2015/ Plean Oidhreachta, Contae Atha Cliath Theas 2010 -2015”. Dublin 2010

Irish Heritage Council, “A Methodology for Local Authority Heritage Officers on the Preparation of County/City Heritage Plans”, July 2013

Shënim: metodologjia dhe shembujt e planeve të trashëgimisë irlandeze mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Këshillit të Trashëgimisë - <http://www.heritagecouncil.ie/home/>

M. Qaflehi, Opoja and Gora through the Centuries, Institute of Albanology, Prishtina 2011

Mr.Sc.F. Dolli, Arkitektura tradicionale – popullore e Kosovës/Traditional Popular Architecture of Kosovo (Catalogue of heritage scientific exhibition – Kosova 2001)

OSCE Mission in Kosovo Factsheet 2014, “Municipal profiles March 2014”

Portraits of Historic Districts in Kosovo and the Balkan Region, 2011 (publikim i CHwB)

Regional Development Agency South, established with the initiative of the European Commission Liaison Office, Prizren 2009 (<http://www.rda-south.org>)

S.Petković, Zidno slikarstvo na području Pečke patrijaršije 1557-1614, Novi Sad 1965 (in Serbian, Cyrillic)

Survey of Cultural Heritage Assets in Dragash/Dragaš Municipality, Final Report prepared by C. Whitaker, 2013 (publikim i UNDP)

V. Đurić, Vizantijske freske u Jugoslaviji, Beograd 1975 (in Serbian, Cyrillic)

SHTOJCAT

Shtojca 1 - Veprimet Pilot

Si pjesë e qasjes së integruar, dhe krahas hulumtimeve të zhvilluara mbi trashëgiminë kulturore të ndërtuar dhe trashëgiminë natyrore, në vitin 2014 u vlerësuan praktikat e trashëgimisë jo materiale të shënuara më poshtë. Kjo ishte pjesë thelbësore e fazës së punës së integruar në terren dhe raportit të studim fizibilitetit i cili ka krijuar një platformë të mirë për zhvillimin e Planeve Rajonale të Trashëgimisë. Trashëgimia jo materiale e shënuar është identifikuar dhe pranuar si vlerë trashëgimoree komuniteteve, si mostra të trashëgimisë së pasur dhe të shumëllojshme të rajonit. Puna e vazhdueshme nën Planin e Trashëgimisë do ta shtojë këtë listë në baza progresive, në rritje dhe të planifikuara.

Gjatë periudhës Gusht - Tetor 2014, pilot veprimet për praktikat e Trashëgimisë jo materiale janë implementuar në të katër rajonet, duke inkurajuar përfshirjen aktive të komunitetit. Këto pilot veprime u kanë prezantuar palëve lokale të interesuara elemente jo materiale të llojllojshme, duke e bërë secilin rajon shumë specifik dhe unik por njëherit edhe komplementar për njëri-tjetrin.

Pilot veprimet e Rajonit Jugor kanë përfshirë:

- *Ditët e Trashëgimisë Jo Materiale "Hajde" duke përfshirë:*
 - Punëtorinë e filigranit në Prizren
 - Ngjyrosja e fytyrës nga rajoni i Zhupës
 - Këngët rapsodike nga Malisheva
 - Kostumet tradicionale dhe ritualet nga rajoni i Hasit
- Aktiviteti i Ditës së Bajrakut, komuniteti rom
- Čader za mlajnesta, çadra tradicionale për martesat, komuniteti goran
- Muzika tradicionale dhe instrumenti Nibet, komuniteti boshnjak

Shtojca 2 - Anëtarët e Grupeve të Punës

Partnerët kryesor

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren
OJQ Ec Ma Ndryshe

Grupi Punues Rajonal

Hasan Hoti, Drejtor i QRTK-Prizren; Samir Hoxha, Drejtor i Departamentit për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit; Sherife Qengaj, Departamenti për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit; Bajram Basha, Departamenti për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit; Demir Zekolli, Departamenti për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Suharekës; Lydra Hoxha, studente e arkitekturës, Komuna e Suharekës; Sefer Basha, OJQ 'AIPK', Komuna e Suharekës; Xhavit Sopaj, ekspert i trashëgimisë kulturore, Komuna e Malishevës; Mevludin Mazreku, Drejtor i Departamentit për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Malishevës; Izet Shala, OJQ KPA, Komuna e Malishevës; Ylber Kastrati, Këshilltar, Komuna e Mamushës; Erol Morina, Shef i Departamentit për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Mamushës; Valon Xhabali, OJQ Ec Ma Ndryshe, Komuna e Prizrenit.

Anëtarët e Grupit Punues Ndërkomunal (Prizren dhe Suharekë)

Shpresa Siqeca, QRTK-Prizren; Medisa Sagdadi, Qendra Informuese Turistike, komuna e Prizrenit; Bajram Basha, Departamenti për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit; Sherife Qengaj, Departamenti për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit; Urim Ukimeri, Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit; Vesel Hoxha, arkeolog, Komuna e Prizrenit; Demir Zekolli, Departamenti për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Suharekës; Xhavit Mala, biolog, Parku Kombëtar i Sharrit; Refki Gollopeni, OJQ Elena Gjika, Komuna e Suharekës; Sefer Basha, OJQ AIPK, Komuna e Suharekës; Lydra Hoxha, studente e arkitekturës, Komuna e Suharekës; Qazim Voci, mësues, Komuna e Suharekës; Enesa Xheladini, OJQ Ec Ma Ndryshe, Komuna e Prizrenit.

Anëtarët e Grupit Punues Ndërkomunal (Malishevë dhe Mamushë)

Lindita Koqbashliu, QRTK-Prizren; Muharrem Morina, Zyra e Kryetarit të Komunës, Komuna e Malishevës; Blerta Krasniqi, Drejtor i Departamentit për Kulturë, Komuna e Malishevës; Kushtrim Morina, Departamenti për Kulturë, Komuna e Malishevës; Naim Avdijaj, Departamenti i Administratës, Komuna e Malishevës; Mehdi Krasniqi, Departamenti i Rinisë, Komuna e Malishevës; Hana Bytyqi, Shefe e bibliotekës së qytetit, Komuna e Malishevës; Izet Shala, OJQ KPA, Komuna e Malishevës; Mevludin Mazreku, shoqëria civile, Malishevë; Ylber Kastrati, këshilltar, Komuna e Mamushës; Erol Morina, Shef i Departamentit për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Mamushës; Resat Mazrek, Departamenti i Prokurimit, Komuna e Mamushës;

Vullnetarët dhe Anketuesit


Leonita Kovaqi
Bekim Krasniqi
Suad Tosuni
Fatlum Kryeziu
Sheilla Avdiq
Laura Lutfiu Hoxha
Ardian Muqaj

Ekspertët, përfaqësuesit e institucioneve/autoriteteve dhe kompanive private të përfshira:

Terry O'Regan, ekspert i Këshillit të Evropës – Irlandë
Liam Scott, Këshilli i Trashëgimisë të Irlandës
Valmira Gashi, eksperte nga MMPH
Fadil Bajraktari, ekspert nga MMPH
Nora Arapi, pikë fokale e PDKK-së nga MKRS
Uragan Alija, ekspert lokal mbi analizën e mbledhjes së të dhënave
Rexhep Kqiku, zhvillues i programeve për web
Kompania ASHA

Shtojca 3 - Metodologjia e zhvillimit e bazuar në komunitet (Junik)

a. Diagrami



b. Rasti studimor i Junikut

http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/Publications/Junik-Case-Study_en.pdf

c. Broshura e Programit Gurët që Flasin

http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/Publications/Stones_en.pdf

d. Rasti studimor i Prishtinës

<http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/Publications/20130129-PristinaCS.pdf>

Shtojca 4 - Lista Kontrolluese e Konsiderimeve Strategjike në zbatimin e qasjes së integruar

A. Angazhimi Komunitetit dhe Ngritja e Vetëdijes

- Mbledhja e vazhdueshme gjithëpërfshirëse e të dhënave dhe validimi sipas standardeve të pranuar ndërkombëtarisht.
- Vlerësimi i strukturave lokale, ndikimet dhe qështjet për të kuptuar më mirë nevojat dhe kërkesat e palëve të interesuara.
- Ndërtimi i kapaciteteve në mesin e palëve të interesuara për të ngritur vetëdijen lokale/rajonale mbi problemet e trashëgimisë dhe diversitetit.
- Bashkëpunimi, dhe garantimi i një niveli të caktuar të koordinimit dhe qasjes së vazhdueshme me partnerët relevant.
- Promovimi i këmbimit efektiv të njohurive bazuar në hulumtime dhe fakte.
- Sigurimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve, dhe akomodimi i ideve të ndryshme.
- Planifikimi dhe ndërmarrja e aktiviteteve të njëkohshme për ngritjen e vetëdijes me shtrirje efektive tek të gjitha komunitetet dhe autoritetet, me përshtatshmërinë e nevojshme kulturore.
- Sigurimi i strategjive dhe burimeve për fushatat lokale vetëdijësuese, të cilat janë argëtuese dhe arsimore.
- Sigurimi i mekanizmave për vlerësimin e ndikimit.

B. Masat mbrojtëse.

- Sigurimi i zbatimit efektiv të legjislacionit gjithëpërfshirës dhe të përditësuar për mbrojtjen e trashëgimisë.
- Shfrytëzimi i ekspertizës për trashëgimi.
- Zhvillimi i politikave, programeve dhe planeve të duhura të menaxhimit.
- Mbajtja e përgatitjes së vazhdueshme të inventarit dhe regjistrimi i detajuar i kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore në pajtim me kriteret e ofruara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Udhëzuesit për Inventarizimin e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore.
- Monitorimi i zbatimit të projekteve për konservim në pajtim me kriteret dhe procedurat e vendosura, dhe në baraspeshë me kërkesat e arsyeshme të pronarëve/banuesve dhe programet dhe planet e autoriteteve lokale.
- Të njihet "Harta Arkeologjike" e rajonit në mënyrë që të mund të ndërmerren masa parandaluese nëse ndërtimi apo aktivitete të tjera synohen të ndërmerren në fushat me tipare arkeologjike.
- Mbështetje e zhvillimit të udhëzuesve për të nxitur mbajtjen, integrimin dhe përmirësimin e trashëgimisë ekzistuese kulturore dhe natyrore.
- Të qenët vigjilentë, dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive për të nxitur partnerët në revitalizimin e trashëgimisë së ndërtuar në mes të institucioneve përgjegjëse, autoriteteve lokale dhe pronarëve.
- Përqendrimi në ndikimin afatgjatë në zhvillimin e një qasjeje të integruar drejt një rrjeti të qëndrueshëm dhe të integruar të parqeve dhe rezervateve kombëtare.

C. Planifikimi dhe dizajnimi

- Vlerësim i thuktë me të gjitha palët e interesuara, posaçërisht komunitetet lokale.
- Analizë realiste e kapaciteteve organizative dhe operacionale.
- Bashkëpunim dhe koordinimi i shtuar në mes të institucioneve, shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale.
- Plani gjithëpërfshirës për Menaxhimin e Trashëgimisë; vënia e prioritetëve, vlerësimi teknik dhe studimi i fizibilitetit.
- Vëmendje e veçantë për përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara.
- Ndjeshmëri ndërkulturore kundrejt grupeve ekzistuese bazuar në moshën, lokacionin gjeografik, aftësinë, gjininë, racën dhe përkatësinë etnike.
- Analizë gjithëpërfshirëse e mundësive për grumbullimin e fondeve dhe trendeve të tregut.
- Fushatë efektive për Informimin Publik
- Monitorim i planifikuar mirë dhe mekanizëm vlerësimi, duke pasur parasysh fazën përcjellëse.
- Dokumentimi në kohë dhe i saktë.
- Mundësitë e duhura profesionale për zhvillim.

D. Masat menaxhuese kërkojnë:

- Të qenët besnik ndaj parametrave të vendosur nga palët e interesuara.
- Sigurimin e kontrollit sistematik të cilësisë së të mirave dhe shërbimeve.
- Mbajtja e një baraspeshe në mes të detyrave dhe procesit.
- Trajtimi i monitorimit dhe vlerësimit si një proces mësimi.
- Baraspeshimi i kujdesshëm i burimeve financiare dhe njerëzore, dhe aktiviteteve të programit.
- Ndërmarrja e vlerësimeve të rregullta dhe analizimit të dhënave për të qenë në gjendje që t'iu përshtaten ndryshimeve.
- Vetëdijësimi për lidhjet e mundshme dhe mundësitë e bashkëpunimit për të ruajtur burimet dhe për të ndërtuar partneritetet.
- Ofrimi i përditësimeve të rregullta për palët e interesuara mbi progresin e projektit për të përforcuar angazhimin.
- Promovimi i punëve të kryera për të dëshmuar progresin dhe për të tërhequr donatorët, partnerët dhe investitorët e brendshëm dhe të jashtëm.

5.5 Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi përfshijnë:

- Të kuptuarit se Turizmi i Trashëgimisë mund të jetë një kontribues madhor për zhvillimin ekonomik lokal.
- Të kuptuarit se projektet për trashëgimi mund të shtojnë turizmin trashëgimor kur ato zhvillohen si pjesë e një pakoje të integruar të turizmit trashëgimor. Do të ishte e dobishme që të caktohet prioriteti i projekteve të cilat janë të lidhura me infrastrukturë të mirë të turizmit dhe zhvillimet komerciale siç janë restorantet dhe ofrimi i akomodimit.
- Sigurimi i përfshirjes dhe integritetit të popullsisë me lokalitetet e trashëgimisë lokale dhe zhvillimin e ndërlidhur të turizmit trashëgimor.
- Gjatë zhvillimit dhe prezantimit të turizmit trashëgimor, të qenët i ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor të popullatës lokale dhe turistëve.

- Përpjekja për të prezantuar një përshkrim të baraspeshuar të trashëgimisë dhe historisë së rajonit, duke u siguruar që prezantimet dhe informacioni i ofruar të jetë i bazuar gjatë gjithë kohës në njohuri të shëndosha profesionale dhe hulumtime.
- Të sigurohet që një pjesë e arsyeshme e të ardhurave të gjeneruara nga turizmi trashëgimor të kanalizohet në konservimin e trashëgimisë.
- Njohja e rrezikut të vetvetishëm se eksploatimi i një dimensionit të trashëgimisë si atraksion turistik në një zonë mund të kërcënojë konservimin e madje edhe vet ekzistencën e burimeve të tjera të trashëgimisë në atë zonë.
- Të kuptuarit se turistët e trashëgimisë do të presin standarde të pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me infrastrukturën lokale fizike dhe mikpritjen.
- Para se të prezantohen lokalitetet e trashëgimisë si atraksione turistike, të sigurohet se janë vendosur masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë.
- Para se të prezantohen lokalitetet e trashëgimisë si atraksione turistike, të sigurohet se janë adresuar qështjet e ndërlidhura me shëndetin dhe sigurinë.
- Të kuptuarit se turizmi i pakoordinuar i trashëgimisë mund të rrisë ndikimin negativ tek popullata lokale siç është humbja e privatësisë, shtimi i tollovisë në trafik, dëmtimi i pronës dhe mjedisit lokal publik si dhe çrregullimin e jetësës lokale.

Në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor", ky Plan i Trashëgimisë shënjon rrugën për rilidhje, ribashkim dhe pajtim mes njerëzve, tokës dhe trashëgimisë së tyre. Plani arrin deri te diaspora e gjërë e çdo komune me qëllim të hartimit të rrefimit të përbashkët të urtësisë, të kuptuarit dhe të përparimit, duke ua dhënë kështu të gjithë qytetarëve një proces dinamik për ndarjen e këtij rrefimi me fqinjët dhe vizitorët e tyre."



Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ajo përbëhet nga 47 shtete anëtare , 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut , një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr implementimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik e politik midis 28 vendeve demokratike evropiane. Qëllimet e tij janë paqja, prosperiteti dhe liria për 500 milionë qytetarët e saj - në një botë më të drejtë, më të sigurtë. Për ti realizuar gjërat, vendet e BE-së kanë krijuar organet për të udhëhequr BE-në dhe për të adoptuar legjislacionin e saj. Ndër organet më kryesore janë Parlamenti Evropian (që përfaqëson popullin e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (që përfaqëson qeveritë nacionale) dhe Komisioni Evropian (që përfaqëson interesat e përbashkëta të BE-së).

<http://europa.eu>

Support to the Promotion of Cultural Diversity

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe